



Namazi në vende ku ka varr

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد : أما بعد

إن الحمد لله نحمده و نستعينه و نستغفره و نعوذ بالله من شرور أنفسنا و سيئات أعمالنا من يهده الله فلا مضل له و من يضلل فلا هادي له أشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له و أشهد أن محمدا عبده و رسوله، أما بعد

Me të vërtetë të gjitha lavdërimet i përkasin All-llahut,
Atë e lavdërojmë dhe prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje.
I kërkoj strehim dhe mbrojtje All-llahut nga te këqijat e veteve tona, dhe nga veprimi i punëve të këqija dhe ndëshkimi për shkak tyre.
Atë që e udhëzon All-llahu nuk ka kush e humbë, dhe atë që e le në humbje, nuk ka kush t'a udhëzoje.
Dëshmoj (deklaroj) se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç All-llahut, vetëm Ai -- (dmth : vetëm Ai e meriton adhurimin) nuk ka ortak.
Dhe dëshmoj (deklaroj) se Muhammedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij.

Dhe më pas:

Profeti sal-lall-llahu alejhi ka thënë:

ألا إن من كان قبلكم كانوا يتخذون قبور أنبيائهم و صالحهم مساجد
ألا فلا تتخذوا القبور مساجد إني أنهاكم عن ذلك

Kuptimi:

(Ata që ishin para jush i bënin varret e profetëve të tyre dhe njerëzve të devotshëm vendfalje (xhamia).
Vini Re! Mos i bëni varret vendfalje.)

[MUSLIMI]

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem i ka mallkuar ata që i bëjnë varret vendfalje.

Hadithet në lidhje me këtë janë të shumta dhe të njohura.

Fjala e Profetit "MOS I BËNI VARRET VENDFALJE" ka tre kuptime, dhe nxirren prej tij tre çështje:

- 1) Falja në varreza.
- 2) Falja në drejtim të varreve.
- 3) Ndërtimi i xhamiave mbi varre.

Thotë shejh Albani në [Tehdhir Es-sexhid]:

الذي يمكن أن يفهم من هذا اتخاذ إنما هو ثلاث معان

الاول: الصلاة على القبور ، بمعنى السجود عليها

الثاني: السجود إليها و استقبالها بالصلاة و الدعاء

و الثالث: بناء المساجد عليها و قصد الصلاة فيها... بكل واحد من هذه المعاني قال طائفة من العلماء

(Kuptimi)

"Ajo ç'farë mund të kuptohet prej fjalës "**BËRJA E VARREVE VENDFALJE**" është:

E para: Namazi në varreza, me kuptimin sexhdja në varre (dmth: të falësh namaz aty).

E dyta: Sexhdja në drejtim të varreve, kthimi në drejtim të varreve kur falemi, apo lutemi.

E treta: Ndërtimi i xhamiave mbi varre dhe synimi për t'u falur në to.

Për secilin kuptim prej këtyre kuptimeve ka fjalë dijetarësh." -F-

Shejhu thotë: "*Në mendimin e Imam Shafiut, fjala e Profetit 'BËRJA E VARREVE VENDFALJE' i përfshin të tre kuptimet.*" -F-

Te ky mendim anon edhe vetë Shejkh Albani.

■ Çeshtja e parë: (Kuptimi i parë) - **FALJA NË VARREZA**

Ka mospajtim te dijetarët në lidhje me faljen e namazit në varreza.

- Malikitë thonë: "Namazi në varreza është i lejuar, nëse nuk ka papastërti."

- Hanefitë dhe Shafiitë thonë: "Namazi në varreza është i papëlqyer."

- Hanbelitë thonë: "Namazi në varreza nuk lejohet."

[Ibn El mundhir, Ibn Kudame]

Mendimi më i saktë është mendimi i atyre që e konsiderojnë të ndaluar, duke u bazuar në disa argumenta.

Hadithi:

(الأرض كلها مسجد إلا المقبرة و الحمام)

Kuptimi:

(Toka e gjitha është vendfalje përveç varrezave dhe banjove (banjo publike ku lahen njerëzit bashkarisht).

[Termidhiu, Ibn Maxhe, Sahih-Albani]

Hadithi:

عن أنس رضي الله عنه قال: نهى رسول الله صلى الله عليه وسلم عن الصلاة بين القبور)

Kuptimi:

(Ka ndaluar Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem nga falja e namazit brenda në varreza).

[Ibn Hibban. Sahih-ALBANI]

Thotë Bin Bazi:

، الصلاة عند القبور و الصلاة ذات الركوع و السجود لا تجوز

كل قبر يصلي عنده فقد اتخذ مسجدا

"Namazi në varreza, namazi me ruku dhe sexhde nuk lejohet.

Çdo varr në të cilin falet, e ka marrë (bërë) atë vendfalje." -F-

Thotë:

كونه يصلي عند القبور معناه أنه اتخذها مسجدا

"Falja e tij në varre në (varreza) do të thotë se ai i ka marrë (bërë) ato vendfalje." -F-

Thotë Ibn Uthejmini:

لو صلى الإنسان في المقبرة فإنه لا يصح أن يصلي في المقبرة سواء كانت القبور خلفه أو عن يمينه أو عن شماله أو أمامه

"Nuk është e sakte të falet njeriu në varreza, si në rastin ku varret i ka mbas tij, apo nga e djathta e tij, apo nga e majta, apo para tij." -F-

Thotë Shejh Feuzani:

لا يجوز إلا صلاة الجنازة فقط

"Nuk lejohet (namazi në varreza) përpos namazit të xhenazes." -F-

Thotë shejkh Albani kur u pyet për namazin në varreza se ç'farë gjykimi ka:

محرمة لا تجوز: U përgjigj:

"Është e ndaluar, nuk lejohet." - F-

Pra, më e sakta është që nuk lejohet falja e namazit në varreza (farz apo nafile).

Duke u bazuar në argumente të sakta të cilat specifikojnë ndalesën.

Ata që e lejojnë faljen në varreza, bazohen në argumente të përgjithshme si për shembull:

Hadithi:

جعلت لي الأرض مسجدا و طهورة

Kuptimi:

"Më është bërë mua toka vendfalje dhe pastrues (dmth: me marr tejemum me të, në mungesë të ujit)"

Ky hadith është i përgjithshëm, ndërsa hadithet që e ndalojnë janë të veçanta.

Rregulli thotë: të veçantës i jepet përparësi ndaj të përgjithshmes.

Nëse e fal namazin në varreza, a pranohet?

Ka mospajtim:

- Shumica e dijetarëve thonë se namazi është i saktë.

Thotë Ibn Rexheb:

. و أكثر العلماء على أنه لا تجب الإعادة بذلك

"Shumica e dijetarëve janë të mendimit që nuk është detyrë të përsëritet" -F-

Dmth: nëse e fal namazin në varreza, namazi është i saktë. Nuk është detyrë të përsëritet.

▪ Disa dijetarë tjerë thonë se nuk pranohet namazi në varreza.

Ky është mendimi i Ibn Hazm, Ibn Tejmijes, Sheukanit, Bin Bazit, Albanit dhe Ibn Uthejmin.

Mendimi më i saktë është mendimi i atyre që thonë se namazi është i kotë. Nuk është i saktë.

Kjo sepse kur ndalesa lidhet me adhurimin e bën të kotë namazin.

Thotë shejkh Albani:

إذا كان النهي لمعنى يختص بالعبادة فيبطل الصلاة،

و إذا لم يكن مختصا بالعبادة لا يبطلها.

و قال رحمه الله: ان بعض الأصليين قالوا: أن النهي إذا كان من أجل الصلاة يبطل الصلاة

أما إذا كان النهي هو منهي عنه خارج الصلاة ففعل داخل الصلاة فالصلاة صحيحة لكن فاعله آثم

"Nëse ndalesa ka të bëje (lidhet) me adhurimin e bën të kotë namazin.

Disa dijetarë të Usulit thonë: nëse ndalesa është për namazin, e bën të kotë namazin." -F-

Ndalesa këtu lidhet me adhurimin (me namazin).

Kështu që namazi nuk është i saktë.

▪ Falja në varreza përfshin: faljen në varreza (ku ka shumë varre), ashtu edhe faljen ku ka një varr

Thotë Ibn Tejmije:

و ذكر طائفة من أصحابنا أن القبر و القبرين لا يمنع من الصلاة ؛ لأنه لا يتناول اسم المقبرة، و إنما المقبرة ثلاثة قبور فصاعدا، و ليس في كلام أحمد و عامة أصحابه هذا الفرق، بل عموم كلامهم و تعليلهم و استدلالهم يوجب منع الصلاة عند قبر واحد من القبور، و هو الصواب،

المقبرة كل ما قبر فيه ، لا أنه جمع قبر.

"Kanë përmendur një grup prej dijetarëve tanë se një varr apo dy varre nuk ndalojnë nga falja e namazit aty (dmth: nuk konsiderohet namazi i ndaluar aty) sepse nuk e përfshin emri varreza.

Varreza jane tre varre e sipër.

Nga fjala e Ahmedit dhe shumicës së shokëve të tij nuk kuptohet kjo ndarje, por nga fjala e tyre dhe argumentimi i tyre, kuptohet konfirmimi i ndalesës nga namazi edhe në një varr prej varreve.

Dhe ky mendim është më i sakti, (sepse) varrezë konsiderohet çdo vend në të cilin varroset në të dikush."

-F-

Thotë Ibn Uthejmini:

لو كانا هناك ارض أشتريت لأن تكون مقبرة، و لكن لم يدفن فيها أحد، فإن الصلاة فيها تصح

فإن دفن فيها أحد ، فإن الصلاة لا تصح فيها لأنها كلها اسم مقبرة.

"Nëse blihet një tokë për të qenë varreza, por nuk është varrosur dikush aty, namazi është i saktë.

Nëse është varrosur ndonjë aty, atëherë namazi nuk është i saktë, sepse ajo (tokë) e gjitha e ka emrin varreza." -F-

Dmth: përderisa është destinuar për varreza, ajo quhet varrezë. Edhe nëse është varrosur në të qoftë edhe vetëm një person.

E nëse nuk është varrosur akoma asnjë, nuk është akoma varrezë, edhe pse është destinuar për varrezë.

Që do të thotë se konsiderohet varrezë qoftë edhe vetëm me një varr.
Dhe jo me tre e lart siç mendojnë disa.

Nëse një vend dihet që është varrezë, por varret janë të rrafshuara, jo të ngritura (si disa varreza të vjetra) ai vend konsiderohet varrezë, për sa kohë njerëzit e njohin për varrezë, dhe si i tillë nuk lejohet namazi aty.

Shejh Albani thotë:

"Nuk ka dallim, a janë varret e ngritura, apo të rrafshuara." -F-
[Tehdhir Essexhid]

Nëse një vend (tokë) nuk është varrezë, dhe njerëzit nuk e njohin për varrezë, dhe aty ndodhet një varr, lejohet të falesh në atë tokë, nëse varri është larg nga ti.

Thotë shejkh Albani:

فإذا كان هناك أرض ليست مسجداً و صلى فيها المصلي ، و هناك قبر عن يمينه أو عن يساره، بعيداً عنه، فحين ذاك الصلاة في تلك الأرض جائزة ما دام أنه غير مستقبل للقبلة
"Nëse falet në një tokë e cila nuk është xhami, dhe aty (në atë tokë) është një varr, (i cili është) larg prej tij, qoftë në të djathtën e tij, apo në të majtën e tij, namazi në këtë rast është i lejuar, përderisa varri nuk është para tij, në drejtim të kibles." -F-

Nëse një banesë është ndërtuar në tokë të pastër, jo mbi varre dhe përreth saj ka varre, të ndara nga banesa, atëherë namazi në atë banesë është i saktë.

Thotë Bin Bazi رحمه الله

أرض العمارة بنيت عليها العمارة سليمة من القبور ، و لكن حولها قبور ، أمامها أو خلفها، أو عن يمينها ، أو عن شمالها، فلا يضرها ذلك إذا كانت الأرض سليمة ليس فيها القبور
"Kur toka në të cilën ndërtohet banesa është e pastër nga varret (dmth: nuk ka patur varre në atë tokë), por ka varre përreth saj, para apo pas, nga e djathta e saj apo nga e majta, kjo nuk e dëmton atë (dmth: namazi është i saktë) nëse është e pastër nga varret." -F-

Thotë shejh Feuzani:

ما دام المقبرة منعزلة عن البيت و بينها وبين البيت مسافة كما ذكرت السائلة، فإن الصلاة صحيحة، إنها لا علاقة لها مغفرة
"Përderisa varreza është e ndarë nga shtëpia, dhe ndërmjet varrezës dhe shtëpisë ka distancë, siç e përmend pyetësja, atëherë namazi është i saktë, dhe se ajo nuk ka lidhje me varrezat." -F-

Banesa që ndërtohet mbi varre

▪ **Nuk lejohet ndërtimi i shtëpisë apo diçka tjetër mbi varre,** përpos nëse kanë qenë dikur varre, dhe nuk ka mbetur asnjë gjurmë varri. Janë tretur edhe eshtrat dhe njerëzit nuk e ruajnë si varrezë, madje as nuk e quajnë varrezë. Në këtë rast lejohet ndërtimi aty.

Shumica e dijetarëve Hanefi, Shafii dhe Hanbeli, e lejojnë të përfitohet (çdo lloj përfitimi të dobishëm) prej varrezave në të cilat janë tretur eshtrat e personave të varrosur dhe nuk ka mbetur asnjë gjurmë e tyre.

Nëse është varrezë, dhe njerëzit e ruajnë për varrezë, ka gjurmë varresh dhe ka akoma eshtra, atëherë nuk lejohet të ndërtohet në të.

Transmeton Imam Muslimi nga Xhabir i cili tregon se Profeti ﷺ ka ndaluar të ulemi mbi varr dhe të ndërtojmë mbi varr.

Thotë Bin Bazi:

المقابر لا يبنى فيها ، بل يجب أن يزال البناء.

"Nuk ndërtohet në varreza. Është detyrë të hiqet ajo banesë (e cila është ndërtuar në varreza)." -F-

Thotë Ibn Uthejmini:

...لا يجوز ان يبنى بيت في المقبرة

قال: فإذا بني بيت في المقبرة وجب هدمه، و لا يجوز السكنى فيه

"Nuk lejohet të ndërtohet shtëpi në varreza.

(Dhe thotë): Nëse ndërtohet shtëpi në varreza është detyrë të shembet, dhe nuk lejohet banimi aty." -F-

Pra, nuk lejohet të ndërtohet shtëpi apo diçka tjetër në varreza.

Nëse ndërtohet është detyrë të shembet.

▪ Gjykimi i namazit në banesën e cila është ndërtuar në varreza

Thotë Ibn Uthejmini:

و إذا لم تجز السكنى فيه لم تجز الصلاة فيه

"Dhe kur nuk lejohet banimi në të, nuk lejohet namazi në të." -F-

Ky është mendimi i shejkh Bin Bazit e të tjerë prej dijetarëve.

A është i saktë namazi apo jo?

Përgjigja është ajo që përmenda për namazin në varreza.

SHENIM!

[[Shkronja -F- është shkurtim i fjalës: Fund, me kuptimin: fundi i fjalës së shejhut]]

(2)

■ ÇESHTJA E PARË

---- Pjesa dyte ----

FALJA E NAMAZIT TË XHENAZES NË VARREZA

Ka mospajtim te dijetarët në lidhje me faljen e namazit të xhenazes në varreza.

Shumica e dijetarëve (sipas imam Neueuiut) e konsiderojnë të papëlqyer faljen e namazit të xhenazes në varreza.

Thotë Imam Neueuiu:

تكره الصلاة على الجنازة في المقبرة بين القبور ، هذا مذهبننا ، و به قال جمهور العلماء ، حكاه ابن المنذر عن علي بن أبي طالب ، و ابن عباس و ابن عمر ، و عطاء و ابن سيرين و أحمد و إسحاق و أبي ثور . قال (المنذري) : (و به اقول ، و لم يكرهها أبو هريرة و عمر بن عبد العزيز .

"Është e papëlqyer falja e namazit të xhenazes në varreza (brenda varreve).

Ky është mendimi ynë.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

E ka transmetuar këtë Ibnul Mundhir nga Alij Bin Ebi Talib, Ibn Abassi, Ibn Umeri, Ataa, nga Ibn Sirini, Ahmed, Is'haku dhe Ebu Theur.

Thotë (Ibnul Mundhir): Këtë mendim e kam edhe unë.

Ndërsa Ebu Hurejre dhe Umer Bin AbdulAziz nuk e konsiderojnë të papëlqyer"-F-

Disa dijetarë tjerë e konsiderojnë të lejuar faljen e xhenazes në varreza.

Prej tyre Ebu Hurejre radijall-llahu anhu

Ka transmetuar Abur-rezzak në [Musanefin e tij] me zinxhir të saktë transmetimi (siç thotë Albani) nga Nafi (tabiin) i cili thotë:

صلينا على عائشة و أم سلمة وسط البقيع ، و الإمام يومئذ أبو هريرة و حضر ذلك ابن عمر .

"Kemi falur namazin e Aishes dhe Ummu Selemeh në mes të (varrezave) Bakia dhe Imam atë ditë ishte Ebu Hurejre. Ka qenë prezent aty Ibn Umeri radijall-llahu anhu." -F-

Thotë Bin Bazi All-llahu e mëshiroftë:

لا حرج في ذلك ، صلاة الجنازة يصلى عليها و تفعل في المقبرة .

"S'ka problem. Namazi i xhenazes falet në varreza." -F-

Thotë Ibn Uthejmini All-llahu e mëshiroftë:

إذا صلى على الجنازة في المقبرة فلا بأس .

"Nëse fal namazin e xhenazes në varreza, nuk ka problem." - F-

Thotë Shejh Abbadi All-llahu e ruajt:

فإنه يمكن أن يصلى على الجنازة في المقبرة

"Bën që të falet xhenazja në varreza." -F-

Këta bazohen në atë se Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ia ka falur xhenazen një gruaje pasi e kanë varrosur.

Ndërsa disa dijetarë tjerë e konsiderojnë të ndaluar faljen e namazit të xhenazes në varreza

Këta bazohen në hadithe të përgjithshme dhe të veçanta.

Prej tyre :

نهى رسول الله صلى الله عليه وسلم عن الصلاة بين القبور

Kuptimi:

“Ka ndaluar i Dërguari i All-llahut të falet namazi brenda në varreza.”

[Ibn Hibban, sahih ALBANI]

Namazi këtu është i përgjithshëm. Përfshin edhe namazin e xhenazes.

نهى أن يصلى على الجنازة بين القبور

[Taberani, Sahih ALBANI]

Kuptimi hadithit:

“Ka ndaluar të falet namazi i xhenazes në varreza.”

Thotë imam Albani All-llahu e mëshiroftë:

لا تجوز الصلاة عليها بين القبور لحديث أنس بن مالك رضي الله عنه (أن النبي صلى الله عليه وسلم نهى أن يصلى على الجنازة بين القبور) [كتاب مختصر الجنازة]

"Nuk lejohet falja e namazit të xhenazes brenda në varreza. Duke u bazuar në hadithin e Enes Bin Malik ((Ka ndaluar Profeti të falet namazi i xhenazes brenda varrezave)). -F-

Ky mendim është më i sakti duke u bazuar në këto argumente të qarta.

Ndërsa sa i përket atyre që e lejojnë faljen në varreza, me argumentin se Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ia ka falur namazin një gruaje te varri saj, pasi është varrosur, përgjigja ndaj kësaj është:

- Kjo mund të jetë e veçantë për Profetin, sepse ka ardhur në hadith:
إن هذه القبور مملوءة ظلماً على أهلها وإن الله ينورها بصلاتي
(Këto varre janë të mbushura me errësirë. Me të vërtetë All-llahu i ndriçon ato me namazin tim)
Ky është mendimi i Malikive dhe Hanefive.
Por më e sakta është që kjo nuk është e veçantë për Profetin, sepse nuk ka argument. Por është në rastin kur nuk ia ke falur para se të varroset, ia fal pasi të varroset.
- Ky është veprim, ndërsa ndalesa është fjalë. Rregulli thotë: "Fjala është më parësore se veprimi."
- Fjala e Profetit tregon ndalesë, ndërsa veprimi i tij (që ia ka falur namazin te varri) është lejesë. Rregulli thotë: "Kur një argument e lejon diçka, dhe një tjetër argument e ndalon atë, i jepet përparësi ndalesës ndaj lejesës."
- Falja e namazit te varri pasi është varrosur nuk është si falja e namazit para se të varroset.

Thotë Shejh ALBANI:

"Ka dallim falja e namazit në varreza, me namazin që falet te varri posaçërisht, pasi është varrosur." -F-

Dallimi qëndron në atë se ti nuk e nxjerr nga varri për t'ia fal namazin jashtë varrezave.

Ndërsa para se muslimani të varroset, mund t'a falësh lehtësisht namazin jashtë varrezave sepse e çon xhenazen jashtë kufinjve të varrezave.

Ndërsa sa i përket asaj se disa Sahabe, e kanë falur namazin e xhenazes në varreza:

Veprimi i disa Sahabëve nuk është argument, sidomos kur ka argument që tregon të kundërtën.

Si dhe ka sahabe tjerë që thonë të kundërtën.

Pra, mendimi më i saktë është se nuk lejohet të falet namazi i xhenazes në varreza.

Lejohet vetëm nëse është varrosur dhe nuk ia ke fal namazin para se të varroset.

Në këtë rast e fal te varri, edhe nëse ia kanë falur tjerët përpara.

(3)

■ ÇESHTJA E PARË

---- Pjesa e tretë ----

- FALJA E NAMAZIT PASI ËSHTË VARROSUR

Ka transmetuar Buhari dhe Muslimi se Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ia ka fal namazin një gruaje te varri , pasi është varrosur.

Ka mospajtim te dijetarët në lidhje me faljen e namazit te varri, personit i cili është varrosur.

Hanefitë dhe Malikitë thonë:

"Falja e namazit te varri, personit që është varrosur, është e veçantë për Profetin dhe jo për të tjerët."

Ndërsa disa dijetarë tjerë thonë:

"Nuk është e veçantë për Profetin, por lejohet edhe për të tjerët. Madje është sunnet."

Thotë Ibn Abdul Ber [në Temhid]:

من صلى على قبر أو على جنازة قد صلى عليها فمباح له ذلك.

"Lejohet t'ia fale namazin atij që është varrosur, apo xhenazes (e cila akoma nuk është varrosur)." -F-

Thotë shejkh Albani رحمه الله:

إذا كان الرجل فاتته الصلاة على الجنازة-- و دفن الميت ، يجوز أن يصلي على قبره.

"Kur njeriut i ikën namazi i xhenazes dhe është varrosur i vdekuri, i lejohet t'a fale te varri i tij." -F-

Thotë shejkh Bin Bazi رحمه الله:

إذا كنت لم تصل عليه ؛ فصل عليه و لو بعد الدفن.

"Nëse nuk ia ke falur namazin, falja namazin, qoftë edhe pasi është varrosur." -F-

Thotë Ibn Uttejmini رحمه الله:

إذا دفن الميت في القبر جاز أن يصلي عليه.

"Kur i vdekuri është varrosur. Lejohet t'ia falësh namazin." -F-

Është transmetuar nga Aliu, Enesi, Ibn Umeri, Aishe dhe Ebu Musa El Esh'arij se këta ia kanë fal namazin personit pasi është varrosur.

Shejh Albani dhe Bin Bazi thonë se është Sunnet.

Thotë shejh Albani All-llahu e mëshiroftë:

هذا هو من السنة

"Kjo (falja e namazit pasi është varrosur) është prej sunnetit."

U pyet:

حتى و لو صلى عليه صلاة الجنازة؟

A edhe nëse i është fal namazi i xhenazes para se të varroset?

U përgjigj:

، نعم نعم ، الي صلوا عليه ما صلوا عليه من قبل . فهذا من السنة

Po, po. Edhe nëse ia kanë fal përpara, apo nuk ia kanë fal. Kjo (dmth: falja pasi është varrosur) është prej sunnetit." -F-

Thotë Bin Bazi All-llahu e mëshiroftë:

السنة الصلاة على القبر ، إذا كان ما صلى على الميت يستحب أن يصلي على القبر.

"Sunnet është t'ia fale namazin te varri pasi është varrosur.

Kur personi nuk ia ka fal xhenazen të vdekurit para se të varroset, pëlqehet t'ia fale te varri, pasi është varrosur." -F-

● I FALET NAMAZI, SI NË RASTIN KUR NUK IA KANË FALUR PARA SE TË VARROSET, ASHTU EDHE NË RASTIN KUR IA KANË FALUR

Hanefitë dhe Malikitë thonë:

"I falet namazi te varri pasi është varrosur, vetëm në rastin kur nuk ia kanë falur. Ama nëse ia kanë falur para se të varroset, atëherë nuk i falet pasi është varrosur."

Dijetarë tjerë thonë:

"I falet, si në rastin kur ia kanë falur, ashtu edhe në rastin kur nuk ia kanë falur.

Madje ne rastin kur nuk ia kanë falur, është detyrë t'i falet te varri.

Thotë Ibn Uthejmini All-llahu e mëshiroftë:

إذا تأكدت أن شخصا ما لم يصل عليه، فعليك أن تصلي عليه . لأنها فرض كفاية

"Nëse je i sigurtë se një personi nuk i është falur namazi xhenazes, duhet t'ia falësh, sepse ajo është detyrë Kifaje (me të cilin obligohen një grup besimtarësh). Me patjetër duhet t'i falet namazi."

Dmth: është obligim falja e xhenazes. Nëse është varrosur pa ia falur, atëherë është detyrë t'i falet te varri.

[مجموع فتاوى ابن عثيمين 17/149]

● KOHA DERI KUR MUND T'I FALET

Sa i përket kohës se deri kur mund t'i falet namazi, pasi është varrosur, ka mospajtim:

- Disa thonë deri në tre dite.
- Disa thonë deri në një muaj.
- Disa thonë deri sa mos të jetë shpërbërë.
- Ndërsa disa thonë i falet pa kufi kohor.

Ibn Kudame thotë se shumica e dijetarëve thonë: "I falet deri në një muaj."

قال في [المغني] وهذا قول أكثر أهل العلم

"Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve."

[MUGNI]

Thotë shejh Feuzani:

يصلى على الميت الى شهر، فمن كان غائبا و لم يحضر صلى عليه الى مدة شهر.

"I falet namazi të vdekurit, deri në një muaj." -F-

Thotë shejh Bin Bazi:

،فذكر العلماء أنه إذا كان شهر و ما حوله و أقل فلا بأس

- و إذا طالت المدة فلا حاجة إلى ذلك لأن الرسول لم يفعل ذلك بعد طول المدة - عليه الصلاة والسلام

أما إذا طالت المدة على الميت فلا يشرع الصلاة عليه لمن غاب

"Kanë përmendur dijetarët se nëse është një muaj, ose rreth një muaj, apo më pak, nuk ka problem t'i falet namazi.

Nëse zgjatet koha (dmth ka kaluar kohë e gjatë) nuk është e nevojshme t'i falet (dmth: nuk bën).

Sepse i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem nuk e ka bërë këtë pasi ka kaluar një kohë e gjatë.

Nëse të vdekurit i ka kaluar kohë e gjatë (prej kur ka vdekur) nuk është e ligjëruar t'i falet namazi."

Disa dijetarë, prej tyre Ibn Hazmi thonë se nuk ka argument që e kufizon deri në një muaj apo më pak.

Thotë Ibn Hazmi në [Muhallat]:

أما أمر تحديد الصلاة يشهر أو ثلاثة أيام فخطأ،.. لأنه تحديد بلا دليل

"Kufizimi i namazit me një muaj, apo tre ditë, është gabim.. sepse është kufizim pa argument." -F-

Disa dijetarë e lejojnë edhe nëse kanë kaluar shumë vite, por me kushtin që në kohën kur ka vdekur personi, të kesh qenë prej atyre që e ke arrit moshën për t'u falur.

Për shembull: ti je tani 30 vjeç dhe ia fal namazin një personi që ka vdekur para 20 viteve.

Bën t'ia falësh sepse në kohën kur ka vdekur ai, ti ke qenë 10 vjeç, moshë e cila bën për t'u falur.

Ama nëse ke qenë 6 vjeç kur ka vdekur personi, nuk bën t'ia falësh, sepse kjo moshë, nuk është moshë namazi (dmth: moshë kur e kupton se ç'farë është falja, namazi).

Këtë mendim e ka Ibn Uttejmini [Esh-sherh el mumti 5/ 436]:

قال رحمه الله (:و الصحيح أنه تصلي على القبر و لو بعد شهر ، إلا أن بعض العلماء قيده بقيد حسن قال :يشترط أن يكون هذا المدفون... مات في زمن يكون فيه هذا المصلي أهلا للصلاة

.ثم قال (:و من ثم لا يشرع لنا أن نصلي على قبر النبي صلى الله عليه وسلم

و ما علمنا أن أحدا من الناس قال إنه يشرع أن يصلي الإنسان على قبر النبي صلى الله عليه وسلم

.او على قبور الصحابة ، لكن يقف و يدعوا

Ky kusht që e përmend Ibn Uttejmini nuk është i saktë, pasi nuk ka argument për të.

Thotë shejh Albani رحمه الله:

. و أن الجواز لا يقيد بيوم او ليلة ، و إنما بعلمه الحادث بالوفاة و الدفن

"Lejesa (për faljen e namazit të personit që ka vdekur dhe është varrosur) nuk kufizohet me një ditë apo një natë, por kufizohet me dijen (dhe e lajmin) e vdekjes së personit dhe varrimin e tij." -F-

Dmth: kur t'i vije lajmi që filani ka vdekur dhe është varrosur, atëherë i lejohet t'ia fale namazin, edhe nëse i vjen lajmi pas disa kohësh.

Ky mendim është mendimi më i përafërt me argumentin.

Sepse argumenti tregon se Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem sapo u njoftua për atë gruan që e kishin varrosur, shkoi menjëherë për t'ia fal namazin te varri i saj.

Nëse personi njoftohet për vdekjen dhe varrosjen e filanit dhe nuk shkon për t'ia fal sapo u njoftua, por e neglizhon pa arsye, dhe shkon pas disa ditëve për t'ia fal, ky veprim është jashtë asaj që na tregon argumenti.

Dmth: nëse njoftohet dhe nuk shkon, pa arsye, nga neglizhenca, ky nuk mund të shkojë pas disa ditëve që t'ia fale namazin.

Nëse kalon kohë dhe nuk shkon për t'ia fal namazin, edhe pse ka justifikim, nuk bën t'ia falësh më.
Për shembull: t'ia falësh namazin një personi që ka vdekur para disa muajsh.

Nëse ne ia hapim rrugën kësaj, atëherë i bie që t'ia falim edhe atij që ka vdekur para ca vitesh, por kjo nuk bën.

Sepse nëse i hapet rruga kësaj, atëherë i bie që edhe atyre që kanë vdekur para shumë vitesh t'ua falim namazin, dhe kështu futemi në një zinxhir, hallkat e të cilit na çojnë deri në kohën e Profetit dhe shokëve të tij.

Dmth: që t'ua falim namazin edhe atyre.

Sepse nëse ia falim xhenazen atij që ka vdekur para pesë viteve, pse mos t'ia falim edhe atij që ka vdekur para shtatë viteve.

Nëse ia falim namazin atij që ka vdekur para 20 viteve, pse mos t'ia falim edhe atij që ka vdekur para 40 viteve, sepse ai thotë s'ka argument që bën dallim kohore.

E kështu me rradhë deri sa dikush thotë pse mos t'ia falim edhe Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Pra, nëse i hapet rruga që t'i falet namazi personit që ka vdekur para disa viteve kjo na çon në një zinxhir hallkat e të cilit shkojnë deri në kohën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Por kjo nuk lejohet, sepse nuk e kanë bërë Selefët tanë të mirë.

Atë gjë që nuk e kanë bërë ata, nuk lejohet t'a bëjmë ne.

Pra, nëse vdes një i afërm i yti, apo një person me ndikim, por ti nuk e di dhe njoftohesh pasi është varrosur, lejohet të shkosh te varri dhe t'ia falësh namazin.

Nëse je në udhëtim dhe kthehesh pas disa ditëve, bën që sapo të vish, të shkosh t'ia falësh namazin te varri i tij.

Pra, sapo të njoftohesh.

Dhe sapo të kthehesh nga udhëtimi, dhe jo t'a vonosh.

All-llahu e di më së miri.

All-llahu është më i Dituri.

(4)

■ ÇESHTJA E PARË

----- pjesa e katërt-----

Tema: NAMAZI I XHENAZES NË MUNGESË

Namazi i xhenazes në mungesë është:

falja e namazit të xhenazes së një personi i cili për shembull: ka vdekur në Saudi dhe njerëzit në një vend tjetër (për shembull: në Shqipëri) ia falin xhenazen atij, edhe pse xhenazja i është falur në Saudi.

Ka mospajtim te dijetarët në lidhje me faljen e namazit të xhenazes së një personi në mungesë.

Hanefitë dhe Malikitë thonë: *“Nuk është i ligjësuar namazi i xhenazes së një personi në mungesë.”*

Arsyja është sepse Hanefitë dhe Malikitë e konsiderojnë kusht prezencën e trupit kur falet xhenazja. Dhe për rastin kur Profeti ia ka fal namazin Nexhashiut, thonë: “Kjo është e veçantë për Profetin, sepse mundet që All-llahu t’ia ketë sjellë trupin e Nexhashiut te Profeti në Medine dhe Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ia ka falur xhenazen duke qenë prezent Nexhashiu. Gjë e cila nuk i mundësohet dikujt tjetër.”

Ky pretendim nuk është i saktë, sepse nuk ka argument që e dëshmon diçka të tillë.

Origjina është që çdo veprim i Profetit në çështje fetare është ligjërimit për të gjithë, përveçse nëse ka argument që e bën të qartë se është i veçantë për Profetin sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Por, nuk ka argument që vërteton se kjo është e veçantë për Profetin sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Shafiitë dhe Hanbelitë thonë: *“Kjo është e ligjësuar për të gjithë dhe nuk është e veçantë për Profetin.”*

[Argumentohen me origjinën që e përmenda më lart]

Ata që e konsiderojnë të lejuar namazin e xhenazes në mungesë, janë ndarë në dy grupe në lidhje me atë se kujt i falet:

- 1) Grupi i parë thonë: *“I falet besimtarit që ia kanë falur në vendin e tij, po ashtu edhe atij që nuk ia kanë falur.”* Ky është mendimi i Shafive dhe Habelive.
- 2) Grupi i dytë thonë: *“I falet vetëm atij që nuk i është falur namazi i xhenazes. Ndërsa t’ia falësh atij që ia kanë falur në vendin e tij, kjo nuk lejohet.”*

Grupi i cili e lejon faljen e namazit të xhenazes në mungesë edhe të atij që ia kanë fal, janë ndarë në dy mendime në lidhje me personin:

- 1) Disa thonë: *"Lejohet për të gjithë."*
- 2) Disa thonë: *"Nuk lejohet për të gjithë, por vetëm për ata persona me pozitë në dije dhe në devotshmëri. Si dhe për ata që kanë dhënë kontribut në shoqërinë Islame."*

Thotë shejh Bin Bazi:

أما أفراد الناس فلا تشرع الصلاة عليهم لأن الرسول صلى الله عليه وسلم ما صلى على كل غائب ، إنما صلى على شخص واحد له قدم في الإسلام .

"Nuk është e ligjëruar që çdo personi me ia fal namazin në mungesë, sepse Profeti nuk ia ka fal çdo personi, por një personi që ka pozitë, përparësi në dije dhe devotshmëri. Si dhe kontribut në Islam." -F-

Ibn Tejmije ka përmendur në [El Fetaua el Kubra] një transmetim nga Imam Ahmedi i cili thotë:

إذا مات رجل صالح صلى عليه

"Kur të vdesë një burrë i devotshëm, i falet namazi i xhenazes në mungesë." -F-

I këtij mendimi është Shejh Seadi.

Këtë mendim e ka Lexhnja (Komisioni i Përhershëm).

Mendimi më i saktë është mendimi i atyre që thonë: *"Nuk është i lejuar përveçse për personin të cilit nuk i është falë namazi i xhenazes."*

Këtë mendim e ka Khatabi (dijetar Shafi v.388 hixhri)

Po ashtu Er-Rujani (الرويانى) (dijetar Shafi v.502 hixhri)

Këtë mendim e ka zgjedhur Ibn Tejmije dhe Ibn El Kajjimi.

Ne kohët tona shejh Albani, Ibn Uttejmini e të tjerë.

Thotë Ibn Tejmije:

الصواب: ان الغائب إذا مات ببلد لم يصل عليه فيه، صلى عليه صلاة الغائب... إن صلى عليه حيث مات لم يصل عليه صلاة الغائب.

"Më e sakta është: nëse një person vdes në një vend në të cilin nuk ia kanë fal xhenazen, i falet atij namazi i personit në mungesë.."

E nëse ia kanë fal xhenazen aty ku ka vdekur, nuk i falet atij namazi në mungesë." -F-

Thotë Ibn Uttejmini:

إذا تأكدت أنه لم يصل عليهم فصل عليهم

[مجموع فتاوى ابن عثيمين ١٧/١٤٩]

"Nëse je i sigurt që nuk ua kanë fal namazin, falja namazin atyre." -F-

Shejh Albani e konsideron bidat këtë gjë. Thotë:

ليس من السنة الصلاة على الغائب إلا إذا مات في أرض ليس فيها من يصلي عليه،

و من بدع العصر الحاضر انتشار هذه الصلاة.

"Nuk është prej sunnetit falja e namazit të xhenazes, personit në mungesë."

Përveçse nëse vdes në një vend në të cilin nuk ia ka fal njeri."

Përhapa e këtij namazi është prej bidateve të kohëve të tanishme." -F-

Ky është mendimi më i saktë, sepse nuk ka argument që dëshmon se i falet edhe atij të cilit i është falur.

Sahabët të cilët kanë qenë në qytete (vende) tjera, kur iu ka arritur lajmi i vdekjes së njerëzve të mëdhenj si Ebu Bekri, apo Umeri, nuk ua kanë falur namazin në mungesë.

Gjykimi i namazit në mungesë të atij që nuk i është falur.

Falja e namazit të atij që nuk i është falur, është **obligim kifaje** (obligohen me të disa njerëz).
[Mexhmu fetava Ibn Utthejmini 17/147]

Namazi në mungesë i atij që ka humbur.

Nëse vërtetohet se ka vdekur, i falet namazi i xhenazes.

Namazi në mungesë i atij që është mbytur.

Nëse vërtetohet se ka vdekur, i falet.

Thotë Shejh Feuzani:

إذا تَوَكَّدَ أَنَّهُ مَاتَ صَلَّ عَلَيْهِ

"Nëse vërtetohet se ka vdekur, falja namazin." -F-

U pyet Ibn Utthejmini: A i falet namazi një personi i cili ka humbur në det, dhe gjykatësi ka gjykuar se ai konsiderohet i vdekur?

U përgjigj Shejhu:

نعم يصلى عليه صلاة الجنازة ما دام أنه حكم بموته.

"Po, i falet atij namazi i xhenazes përderisa është gjykuar se ka vdekur." -F-

● SI FALET NAMAZI I XHENAZES PERSONIT NË MUNGESË?

Nëse vërtetohet se filan person i cili ka vdekur, nuk i është fal xhenazja, është detyrë për një grup njerëzish t'ia falin namazin e xhenazes.

Namazi i falet sapo të njoftohen njerëzit dhe jo të lihet për ditë tjetër, apo për të xhuma, siç mendojnë disa, sepse nuk ka argument.

Argumenti tregon se kur Profeti sal-lall-Ilahu alejhi ue sel-lem u njoftua për vdekjen e Nexhashiut, i njoftoi Sahabët dhe ia fali namazin.

Dhe nuk e shtyu ate për të nesërmen, apo për ditën e Xhuma.

Është detyrë t'a falin namazin disa besimtarë.

Dijetarët janë në mospajtim në lidhje me numrin.

Disa thonë: mjafton një person, i cili është Musliman i rritur, që ka arritur moshën e pubertetit dhe është i logjikshëm (dmth: të mos jetë me të meta mendore).

[Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve sipas Shejh Sead Esh-Shethri]

Thotë Bin Bazi

إذا قام بها واحد كفى وأجزأت، لكن السنة أن يصلي عليها للجم الغفير

"Nëse vetëm një njeri ia fal mjafton, dhe është realizuar obligimi." -F-

Disa dijetarë tjerë thonë dy besimtarë.

Disa të tjerë thonë tre, disa katër.

Nuk jam i qartë në atë se cili mendim është më i sakti.

Nv këtë rast anoj te shumica.

والله أعلم.

Është e pëlqyer të falet në xhami, t'a fale imami i xhamisë me xhematin. [BIN BAZI]

Nëse imami nuk ia fal, le të bëhen një grup dhe t'ia falin ku të munden, qoftë edhe në shtëpinë e ndonjërit.

Nëse nuk bëhet një grup, mjafton një person, sipas mendimit të shumicës.

Nëse nuk e fal një burrë e fal një grua sipas mendimit të shumicës.

Nëse e falin në xhami, mjafton, dhe nuk kanë pse t'a falin të tjerët përsëri në vende të ndryshme.

Sepse ky namaz është si namazi i xhenazes së personit prezent.

Kur t'i falet atij xhenazja, nuk mund të përsëritet ajo dhe të falet nga njerez tjerë në xhami apo diku tjetër, sepse kjo nuk ka ndodhur në kohën e Profetit.

Perpos ne varreza.

Nëse e arrin t'a falësh me xhematin e parë, është mirë.

Në të kundërt, t'ia falësh në shtëpi apo diku tjetër, nuk bën.

Përpos në varreza.

Nëse nuk ke arrit me ia fal me xhemat, vjen te varrezat dhe ia fal.

Nëse akoma nuk e kanë varrosur ia fal aty.

Nëse e kanë varrosur, ia fal te varri.

U pyet shejh Albani: "A bën me ia fal në varreza para se me e varros?"

Tha: Po, përderisa bën me ia fal pasi është varrosur, falja para se të varroset është më parësore." -F-

Kjo nuk lidhje me faljen e xhenazes në varreza, mos t'a ngatërrojmë.

Falja e xhenazes në varreza nuk bën (dmth: mos t'a falim në musal-lah apo në xhami, por t'a falim në varreza).

Ama, kur xhenazja është falur në xhami apo në musal-lah, dhe dikujt i ka ik namazi me xhemat, në këtë rast lejohet me shku në varreza me ia fal.

Po e gjeti pa varros e fal ashtu te trupi i tij i kthyer nga kibla.
E nëse është varrosur, e fal te varri, i kthyer nga kibla.

Nëse ndodhesh në një xhami ku Imami dhe xhemati po falin namazin në mungesë të dikujt të cilit i është falur në vendin e tij, ti mos ia fal, dil nga xhamia, sepse konsiderohet namaz jo i ligjëruar.

U pyet shejh Albani:

إذا دخلت يعني المسجد فقالوا صلاة الغائب، أصلي أو أخرج؟

"Kur të hyj në xhami dhe dëgjoj duke thënë: po falim namazin e personit në mungesë! A të falem (me ata) apo të dal?"

U përgjigj shejhu:

، ما تصلي إذا كنت ترى ما نرى لا تصل، و لا تشارك الناس فيما لا ندين الله به
إلا إذا خفت على نفسك لا سمح الله ضررا ، فحينئذ لا حول و لا قوة إلا بالله، تسلك مذهب الشيعة ، و تتقي منهم تقاة

[رحلة النور 129]

"Mos u fal. Nëse ke këtë mendim që kemi ne (dmth: nëse ec me mendimin se nuk bën t'i falet namazi i xhenazes në mungesë atij të cilit i është falur), atëherë mos u fal.

Mos i shoqëro njerëzit në një adhurim me të cilin (në mendimin tënd sipas argumentave) nuk e adhuron All-llahun me të.

Përveçse nëse ke frikë dëmtimin prej tyre, atëherë La haule ue la kuuete il-la bil-lah (falu me ata) që të ruhesh nga dëmtimi i tyre." -F-

■ ÇESHTJA E DYTË.

● FALJA E NAMAZIT NË DREJTIM TË VARRIT

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

(لا تصلوا إلى القبور)

Kuptimi:"

(Mos u falni në drejtim të varreve)

[MUSLIMI etj]

Thotë Sheukani All-llahu e mëshiroftë:

الحديث يدل على منع الصلاة إلى القبور

"Hadithi tregon se ndalohet namazi në drejtim të varreve." -F-

Thotë Ibn Uthejmini:

من فوائد الحديث :تحريم الصلاة إلى القبر ...و من فوائده :أنها اي: الصلاة إلى القبر باطلة و إن كان مكان الصلاة طاهرا فإنه مكان منهي عنه بخصوصه فيقتضي بطلان الصلاة

"Prej dobive të hadithit është qe falja e namazit në drejtim të varrit është haram, dhe se falja e namazit në drejtim të varrit është e kotë (dmth: nuk pranohet), edhe nëse vendi i faljes është i pastër, sepse ai është vend ku ndalesa lidhet posaçërisht me të."

[Bulugul Meram , Sherh Kitabus -salat 08]

Thotë Shejhu:

لا تصل إليها فتجعلها في قبلك فإن هذا نوع من التعظيم

لا يجوز للإنسان أن يصلي إلى القبر لا فريضة و لا نافلة

"Mos u fal drejt tyre (varreve), që të jenë në drejtim të kibles (kur ti faleshë), sepse kjo është lloj madhërimi.

Nuk lejohet të falet në drejtim të varrit, as namaz farz dhe as namaz nafle." -F-

Thotë Shejh Abbadi All-llahu e ruajt:

لا يجوز للإنسان أن يصلي مستقبلا القبر و متجها إلى قبر

"Nuk lejohet për njeriun të falet në drejtim të varrit, i kthyer nga varri." -F-

[Sherh bulug el meram الصلاة باب شروط]

Thotë Bin Bazi:

الواجب عليكم و على غيركم من المسلمين عدم الصلاة إلى القبور ، و أن تكون الصلاة بعيدة عن القبور في محل بعيد عن القبور ، ليس في قبلكم قبور

"Është detyrë për ju dhe për të tjerët, që mos të faleni në drejtim të varreve, por të jetë vendi ku faleni larg varreve.

Dhe mos të jenë varret para kibles (kur faleni)." -F-

Ka prej dijetarëve të cilët e konsiderojnë të papëlqyer faljen në drejtim të varreve.

Mendimi më i saktë është mendimi i atyre që thonë:

“Nuk lejohet, është haram falja në drejtim të varreve, duke u bazuar në argumente të qarta në lidhje me këtë. Dhe se ndalesa në këto argumente është për qëllim harami.”

Që do të thotë se është haram falja në drejtim të varreve.

● NËSE E FAL NAMAZIN NË DREJTIM TË VARREVE, A ËSHTË I SAKTË, APO JO?

Ka mospajtim te dijetarët në lidhje me këtë.

Nëse synon me qëllim faljen drejt varreve, nuk ka dyshim që namazi i tij është i kotë, jo i saktë.

Thotë Shejh Albani:

إذا قلنا أن الصلاة تبطل، طبعاً هذا بالنسبة للقاصد الذي يقصد الصلاة إلى القبر ،
بالنسبة لمن يقصد الصلاة إلى قبر واضح أن الصلاة ليست لله -عز و جل- وإنما لصاحب القبر، فالصلاة باطلة و هو مشرك
أما من لا يقصد الصلاة إلى القبر، فلا يقال أنه الصلاة باطلة

"Kur themi që namazi është i kotë, natyrisht kjo është në lidhje me atë që synon faljen e namazit në drejtim të varrit.

Ai i cili synon me qëllim faljen drejt varrit, është e qartë se namazi (i tij) nuk është për All-llahun, por për personin që është varrosur në atë varr.

Në këtë rast namazi është i kotë, jo i saktë dhe i tilli është mushrik (idhujtar)." -F-

Fjala e Shejhut: (I TILLI ËSHTË IDHUJTAR) është për qëllim kur personi falet për varrin, jo për All-llahun. Apo kur personi kthehet nga varri kur falet dhe jo nga kibla.

Ama nëse personi falet për All-llahun, dhe falet nga kibla, por falet në drejtim të varrit, i cili është në drejtim të kibles, me mendimin se është më mirë, i tilli nuk është mushrik (idhujtar).

Ky veprim është mëkat, ndërsa namazi i tij është i kotë, jo i saktë.

Ndërsa personi i cili falet në drejtim të varrit, me vetëdije se është duke u fal në drejtim të varrit, si dhe e di që nuk bën të falet në drejtim të varreve, nuk ka synim dhe qëllim varrin, por thjesht varri ndodhet mes tij dhe kibles, dhe ky përton të largohet në një vend tjetër, në lidhje me namazin e këtij ka mospajtim.

- Shumica dijetarëve thonë: *"Namazi i tij është i saktë."*

Thotë shejh Albani:

أما من لا يقصد الصلاة إلى القبر فلا يقال أنه الصلاة باطلة .

"Ama, nëse nuk synon me qëllim faljen në drejtim të varrit, (por thjesht varri ndodhet ndërmjet tij dhe kibles, në këtë rast) nuk thuhet se namazi është i kotë, jo i saktë." -F-

- Disa dijetarë thonë: *"Nëse personi falet në drejtim të varrit, duke e ditur që para tij dhe kibles ka varr, si dhe duke e ditur gjykimin se nuk lejohet falja në drejtim të varreve, namazi i tij është i kotë, jo i saktë."*

Thotë Ibn Uthejmini:

الصلاة إلى القبر باطلة باطلة

"Namazi në drejtim të varrit është i kotë, jo i saktë." -F-

Shejhu këtu e përgjithëson, dhe nuk e kufizon.

Shejhu edhe në vende tjera përmend që namazi në drejtim të varrit nuk pranohet.

Mospajtimi i dijetarëve në lidhje me këtë është për shkak të mos pajtimit që kanë në lidhje me ndalesën për bërjen e diçkaje.

A tregon ndalesa për bërjen e asaj pune, se ajo punë nuk pranohet?

Apo thjesht ndalohet të bëhet, dhe se po e bëri, ka gabuar, por puna është e saktë?

Një pjesë e dijetarëve bëjnë dallim ndërmjet ndalesave që lidhen me të drejtën e All-llahut, me adhurimin, dhe ndërmjet ndalesave që lidhen me të drejtën e njerëzve.

Thonë: *"Nëse ndalesa për diçka lidhet me të drejtën e All-llahut (me adhurimin), puna nuk pranohet. E nëse lidhet me të drejtën e njerëzve puna pranohet, por veprimi është gabim."*

Për shembull:

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka ndaluar të falemi në një tokë të grabitur.

Po ashtu ka ndaluar të falemi në varreza, apo në drejtim të varrezave.

- Tek e para, ndalesa lidhet me të drejtën e njerëzve.
Në këtë rast thonë: namazi është i saktë, personi ka gabuar.
- Te ndalesa e dytë thonë: ndalesa këtu lidhet me të drejtën e All-llahut.
Ajo është: madhërimi i All-llahut, adhurimi i tij me singëritet dhe larg shirkut.

Falja në varreza, apo në drejtim të varreve është lloj madhërimi i varreve, dhe mund t'a shpie njeriun në shirk, (siç thonë dijetarët kur tregojnë urtësinë e mos faljes në varreza, apo në drejtim të varreve). Dhe kjo bie ndesh me të drejtën e All-llahut që është madhërimi dhe adhurimi i Tij pa i bërë shirk.

Thonë: *"Në këtë rast puna nuk pranohet, sepse ka të bëjë me të drejtën e All-llahut, apo cënon të drejtën e All-llahut që është madhërimi i tij, adhurimi i tij pa i bërë shirk. Kjo ndarje është e fortë dhe nuk mund të anashkalohet lehtë."*

Personalisht anoj te kjo, por jo plotësisht, për shkak të nevojës që kam për t'a studiuar më shumë si çështje.

Nëse bazohemi në këtë ndarje, atëherë namazi i atij që falet në drejtim të varreve me vetëdije, edhe pse nuk ka synim varrin aspak, namazi i tij është i kotë.

- Nëse personi nuk e di gjykimin fetar në lidhje me faljen në drejtim të varreve, nuk ka gjynah. (Insha All-Ilahu) namazi i tij është i saktë.
- Nëse personi nuk e di (nuk e sheh) që para tij ka varreza, namazi i tij është i saktë.

Thotë Shejh Abbadi:

أما لو لم يدرك أنه قبر، و صلى و لا يدري أن قدامه قبر فإنه لا يؤثر.

"Nëse nuk e di që ai është varr, dhe falet duke mos e dit që para tij ka varr, kjo nuk ndikon." -F-

Dmth: nuk ka problem, nuk ka gjynah dhe namazi është i saktë.

● NDALESA ËSHTË KUR NUK KA NDARËS NDËRMJET

Ndalesa që të falesh në drejtim të varrezave është atëherë kur nuk ka ndarës mes teje dhe varrezave.

Ama nëse ka ndarës, si për shembull: mur, apo rrugë, apo lum, apo pemë të shumta, apo banesa etj.. në këtë rast nuk ka ndalesë.

Thotë shejh Bin Bazi:

، لكن لو كان بينكم وبين القبور جدار يمنعكم منها ، فالصلاة صحيحة

.... او بينكم وبينها مسكن او شيء يمنع منها مثل وادٍ، بينكم وبينها وادي السيل

"Nëse ndërmjet jush dhe varreve ka ndarës, mur që ju ndan nga varrezat, namazi është i saktë.

Ose nëse ndërmjet jush dhe varrezave ka shtëpi, apo banesë, apo diçka që ju ndan nga varrezat (namazi është i saktë)."

Thotë:

. إذا كان جدار آخر غير جدار المقبرة يكون أسلم وأحسن

"Nëse ka mur tjetër, plus murit të varrezave, është më larg dyshimit dhe më mirë." -F-

Thotë shejh Ibn Uttejmini:

فإذا قال القائل: ما هو الحد الفاصل في الصلاة اليها؟ قلنا: الجدار فاصل، إلا أن يكون جدار المقبرة ففي نفسي منه شيء.

، لكن إذا كان جدارا يحول بينك وبين المقابر ، فهذا لا شك أنه لا نهي

. كذلك لو كان بينك وبينها شارع فهنا لا نهي

[الشرح الممتع 2/254]

"Nëse dikush thotë: cili është kufiri ndarës që lejon namazin në drejtim të varreve?

Themi: muri është ndarës.

Përveçse nëse (ajo ndarje) është muri i varrezave, në lidhje me këtë nuk jam shumë i bindur.

Por nëse (ajo ndarje) është mur i cili ndan ndërmjet teje dhe varrezave, atëherë pa dyshim që nuk ka ndalesë (dmth: lejohet namazi).

Po ashtu nëse ndërmjet teje dhe varrezave ka rrugë, nuk ka ndalesë (dmth: lejohet namazi)." -F-

Pra në mendimin e shejh Bin Bazit , të Ibn Uttejminit dhe disa dijetarëve tjerë, nëse ndërmjet teje dhe varrezave ka mure, për shembull: muri varrezave mjafton si ndarës.

Ama më e mira është që plus murit të varrezave, të ketë edhe ndarje tjetër, mur apo diçka.

- Nëse falesh në një banesë, e cila nga ana e kibles ka varre të zbuluara, pa mure, atëherë muri i banesës është ndarës.
- Nëse ka rrugë ndërmjet teje dhe varrezave, atëherë rruga konsiderohet ndarëse. Rrugë është për qëllim rrugë e madhe ku kalojnë njerëz, kafshë, apo makina. Dhe jo rrugicë e thjeshtë.
- Lumi ndërmjet teje dhe varrezave është ndarës.
- Po ashtu nëse je larg varrezave, lejohet falja edhe nëse varret nuk kanë mure. Nëse je afër nuk bën.

Lind pyetja: kur konsiderohet larg dhe kur konsiderohet afër?

Nuk ka argument në lidhje me distancën dhe largsinë se sa duhet.

Ndoshta ajo që bën ndarjen në lidhje me distancën dhe largësinë është: që kur ai falet në një distancë të caktuar mos të mendohet nga dikush që e shikon, se ai me faljen e tij kaq afër varrezave, synon me qëllim faljen në drejtim të varreve.

Thotë Shejh Bin Bazi kur u pyet: a është largësia 15 metra e mjaftueshme?

قد لا يكفي هذا لأن الاستقبال إذا كانت غير مستورة أمامهم قد يحصل بذلك الاستقبال و يظن أنهم قصدوا الاستقبال، فالبعد عنها أسلم.

[binbaz.org موسوعة الفتاوى البازية]

"Mundet mos të mjaftoje kjo distancë, sepse kthimi (në drejtim të varreve) nëse ato janë të zbuluara para tyre (dmth: pa mure), mundet që me këtë të mendohet se këta kanë synuar me qëllim namazin në drejtim të varreve. Kështu që, të qëndrohet sa më larg është më larg dyshimit." -F-

Pra, nëse qëndron në një distancë që mund të duket (mendohet) se ky me qëllim ka synuar faljen drejt varreve, në këtë rast nuk bën.

E nëse rri larg, aq sa ata që e shohin, askush nuk mendon keq për të, atëherë kjo distancë është distanca e lejuar.

(6)

.....

■ ÇESHTJA E TRETË

NDËRTIMI I XHAMIVE MBI VARRE

(1)

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem në shumë hadithe ka ndaluar të bëhen varret vendfalje.

Thotë:

ألا وإن من كان قبلكم كانوا يتخذون قبور أنبيائهم و صالحهم مساجد ، ألا فلا تتخذوا القبور مساجد إني أنهاكم عن ذلك .

Kuptimi:

Ata që ishin para jush i bënin varret e profetëve të tyre dhe njerëzve të devotshëm vendfalje (xhamia).

Kujdes! Mos i bëni varret vendfalje. Unë ju ndaloj nga kjo.”

[MUSLIMI etj.]

Ndalesa nga bërja e varreve vendfalje, përmban (përfshin):

- Ndalesën e faljes në varre (varreza).
Dmth: nuk lejohet të falim namaz në varre (varreza).
- Ndalesën e faljes në drejtim të varreve (apo varrit).
Dmth: nuk lejohet të falim namaz në drejtim të varreve (apo ndonjë varri).
- Ndalesën e ndërtimit të vendfaljeve (xhamive) mbi varre.
Dmth: nuk lejohet ndërtimi i xhamive mbi varre, apo në varreza.

▪ URTËSIA E NDALESËS

Urtësia dhe qëllimi i ndalesës është frika se kjo mund të shpie në shirk.

Thotë Ibn Uthejmini All-llahu e mëshiroftë:

الحكمة من ذلك أن الصلاة في المقبرة أو إلى القبر ذريعة إلى الشرك ، و ما كان ذريعة إلى الشرك كان محرما ؛ لأن الشارع قد سد كل طريق يوصل إلى الشرك .

"Urtësia e kësaj është se falja në varreza, apo në drejtim të varrit është rrugë, shkak që të shpie në shirk.

Dhe çdo rrugë (dhe shkak) që të shpie në shirk është haram (të merret, të veprohet, të behët)." -F-

Ndërtimi i xhamisë mbi varr (apo varre) me synimin e faljes në atë varr, nuk lejohet, konsiderohet mëkat i madh, dhe ata që e bëjnë këtë, janë të mallkuar.

Ndalesa nga ndërtimi i vendfaljeve në varre do të thotë: ndalesa nga falja në varre, sepse qëllimi i ndërtimit të xhamive, është për shkak të faljes së namazit në to.

XHAMITË QË NDËRTOHEN MBI VARRE JANË DY LLOJE

- Xhami të cilat janë ndërtuar mbi varr (apo varreza), pa e ditur që ka varre poshtë, apo që është varrezë.
- Xhami të cilat janë ndërtuar mbi varr (apo varreza), me vetëdije dhe me qëllim që ka varr poshtë.

Xhamia që është ndërtuar mbi varr, apo në varreza pa e ditur që ka varr poshtë, apo që është varrezë, nuk ka problem, përderisa nuk ka shenja dhe gjurmë varresh.

Thotë Shejh Albani All-llahu e mëshiroftë:

القبور المزعوم وجودها في المسجد الحرام غير ظاهرة و لا بارزة و لذلك لا تُقصد من دون الله ، فلا ضرر من وجودها في بطن ارض المسجد ،

، العبرة في هذه المسألة بالقبور الظاهرة ، و ان ما في بطن الأرض من القبور فلا يرتبط به حكم شرعي من حيث الظاهر و من البين الواضح أن القبر إذا لم يكن ظاهرا معروفا مكانه فلا يترتب على ذلك مفسدة كما هو مشاهد

"Varret që supozohet se janë në xhaminë e shenjtë, nuk janë të dukshme, të shfaqura, dhe për këtë nuk synohen nga askush që t'i adhurojnë krahas All-llahut, dhe në këtë rast ekzistenca e tyre në brendësi të tokës nuk dëmton.

Ajo që merret në konsideratë në këtë çështje janë varret e shfaqura të dukshme.

Ndërsa varret që janë brenda tokës (dmth: që nuk shihen, nuk dallohen për varre) nuk lidhet me ato ndonjë gjykim sheriatik.

Dhe dihet qartazi se varri, nëse nuk është i dukshëm dhe i njohur vendi i tij (dmth: që të njihet se ky është varr) nuk paraqet dëm." -F-

[Disa pretendojnë se në xhaminë e shenjtë është varri i Ismailit (alejhis selam), dhe i disa tjerëve, por kjo nuk është e saktë siç thotë shejh Albani dhe dijetarët e tjerë para tij.]

Shejhu thotë që varret nëse janë në brendësi të tokës, por nuk janë të shfaqura, të njohura, dhe njerëzit nuk e dinë që ka varre aty, atëherë nuk ka problem nëse falesh aty, apo nëse është ndërtuar xhami aty.

Pra, xhamia e cila është ndërtuar mbi varre, pa dijeni se aty ka varre, nuk ka problem, përderisa nuk ka asnjë shenjë dhe gjurmë varri.

Namazi në këtë xhami lejohet.

2) Lloji i dytë i xhamive që janë ndërtuar mbi varre: xhami, të cilat janë ndërtuar mbi varre, me vetëdije dhe qëllim, dhe varri (apo varret) aty janë të dukshme.

Xhamitë e ndërtuara mbi varre, me qëllim dhe vetëdije:

- Ose janë ndërtuar me pretendimin se nuk është problem të ndërtohet xhami mbi varre, siç mendojnë disa.
- Ose janë ndërtuar me qëllim madhërimi ndaj atij varri.

Në të dyja rastet është haram ndërtimi i xhamive mbi varre.

Në rastin e dytë, harami është më i madh, dhe janë të mallkuar ata që e bëjnë këtë.

Xhamitë e ndërtuara mbi varr, kur varri është i dukshëm aty:

- Ose duhet të hiqet varri. Të nxirret i vdekuri nga aty, nëse është akoma trup, dhe të hiqet varri. Apo të rrafshohet varri, nëse është tretur trupi dhe të humbe çdo lloj shenje dhe gjurmë e varrit.
- Ose duhet shembur xhamia.

Thotë Ibn Tejmije All-llahu e mëshiroftë:

وإن كان المسجد بني بعد القبر. فإما أن يزال المسجد و إما أن تزال صورة القبر.

"Nëse xhamia është ndërtuar pas varrit (dmth: është ndërtuar mbi varr):

Ose duhet hequr (shembur) xhamia.

Ose duhet të hiqet forma e varrit." -F-

[MEXHMU EL FETAWA]

Dmth: të rrafshohet, dhe të pastrohet, që të mos mbetet asnjë shenjë dhe gjurmë varri.

Thotë Ibn Uthejmini:

، إذا كان المسجد قد بني على القبر فإن الصلاة فيه لا تجوز و هذا المسجد يجب هدمه ، و قال الله للرسول عليه الصلاة والسلام عن مسجد الضرار (لا تقم فيه أبدا ؛ لأن مسجد الضرار يجب أن يهدم فكذلك كل مسجد يجب أن يهدم فإن الصلاة فيه محرمة قياسا على مسجد الضرار.

"Nëse xhamia është ndërtuar mbi varr, namazi në të nuk lejohet. Kjo xhami është detyrë të shembet.

All-llahu i thotë Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem për (mesxhid dirar) xhaminë dëmtuese (të sherrit):

((Mos u fal aty asnjëherë))

Xhamia dëmtuese (e sherrit) është detyrë të shembet.

Dhe çdo xhami, shembja e së cilës është detyrë, namazi në të është haram." -F-

Thotë shejhu (në një vend tjetër):

إذا كان المسجد مبنيا على القبر فالصلاة فيه لا تصح لأن هذا المسجد محرم يجب هدمه.

"Nëse xhamia është ndërtuar mbi varr namazi në të nuk është i saktë, sepse kjo xhami është e ndaluar dhe është detyrë shembja e saj."

Thotë:

فالواجب نبش القبر و إخراج الميت منه و دفنه مع الناس.

"Eshtë obligim zhvarrosja e të vdekurit dhe nxjerrja e tij (nëse nuk është tretur) që të varroset me njerëzit (e tjerë në varreza)." -F-

[مجموع فتاوى ابن عثيمين ج ١٢]

Pra, ndërtimi i xhamisë mbi varr është i ndaluar.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka ndaluar të bëhen varret vendfalje (xhamia) duke thënë:

، ألا و إن من كان قبلكم كانوا يتخذون قبور أنبيائهم و صالحهم مساجد، ألا فلا تتخذوا القبور مساجد إني أنهاكم عن ذلك

Kuptimi:

((Ata që ishin para jush i bënë varret e profetëve të tyre dhe njerëzve të devotshëm vendfalje (xhamia).

Kujdes mos i bëni varret vendfalje (xhamia). Unë ju ndaloj nga kjo))

[MUSLIMI etj..]

Profeti i ka mallkuar ata që i bëjnë varret vendfalje (xhamia).

[BUHARI, MUSLIMI etj]

Kjo tregon se bërja e varreve vendfalje dhe ndërtimi i xhamiave mbi varre është prej mëkateve të mëdha.

Thotë shejh Albani:

اتخاذ القبور مساجد من الكبائر .

"Bërja e varreve vendfalje (xhamia) është prej mëkateve të mëdha."

Thotë: *"Ky është mendimi i Shafive."* -F-

[Tehdhir Es-Sexhid]

Të gjitha medhhebet bien dakord se bërja e varreve vendfalje është haram. [ALBANI]

- Xhamiat që ndërtohen mbi varr me qëllim madhërimi, janë xhamia sherri (mesxhid dirar - dëmtuese).

- Xhamia dëmtuese (sherri) është detyrë të shembet.

- Xhamia që është ndërtuar mbi varr, dhe varri është prezent, është detyrë ose të rrafshohet varri dhe të largohet çdo gjurmë e tij. Ose të shembet xhamia.

Shënim: shembja e xhamisë është detyrë e shtetit. Nëse shteti nuk e shemb, nuk i lejohe individit, apo ndonjë grupi të çohen dhe të shembin xhaminë.

● DISA MENDOJNË SE LEJOHET NDËRTIMI I XHAMIVE MBI VARRE

Disa mendojnë se lejohe ndërtimi i xhamisë mbi varr, dhe bazohen për këtë në disa argumente të pasakta. Prej tyre:

Pretendimi se Ismaili alejhis selam është varrosur në Qabe.

Dijetarët e hadithit, prej tyre shejh Albani thonë:

"Nuk është e saktë. Nuk ka argument të vërtetë që e dëshmon diçka të tillë.

[ALBANI - Tehdhir Es-sexhid]

Hadithi i cili thotë:

في مسجد الخيف قبر سبعين نبيا.

Kuptimi:

((Në xhaminë khaif (apo khiif) është varri i shtatëdhjetë profetëve))

Dmth: janë varrosur shtatëdhjetë profetë.

Thotë Shejh Albani në [Tehdhir Es-sexhid] :

لا صححه أحد ممن يوثق بتصحيحه من الأئمة المتقدمين.

"Nuk e ka saktësuar këtë hadith asnjë prej imamllarëve të parë të cilët kanë autoritetin dhe janë të besueshëm në saktësimin e haditheve." -F-

Prej tyre: historia e Sahabiut Ebu Xhendel i cili ka ndërtuar një xhami mbi varrin e Ebi Besirit.

بني أبو جندل رضي الله عنه مسجدا على قبر أبي بصير في عهد النبي صلى الله عليه وسلم.

"Ebu Xhendel ka ndërtuar një xhami mbi varrin e Ebi Besirit në kohën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem."

Thotë Shejh Albani:

ليس له إسناد تقوم به الحجة و لم يروه أصحاب ((و)) السنن ((و)) المسانيد ((و)) غيرهم.

إنما أورده ابن عبد البر في ترجمة أبي بصير من ((الاستيعاب)) (مرسلا)... مدار هذه القصة على الزهري فهي مرسلة اعتبار أنه تابعي صغير.

[تحذير الساجد]

"Kjo histori nuk ka zinxhir transmetimi. Nuk e kanë transmetuar dijetarët e librave të hadithit, as në (Sihah), as në (Sunen), as në (Musnede), e të tjera." -F-

Pra, ndërtimi i xhamive mbi varr nuk lejohet, është haram i madh.

Kjo gjë është rrugë që të shpie në shirk (All-llahu na ruajt).

Ndërsa pretendimi i atyre që thonë se bën të ndërtohet xhami mbi varr, është pretendim i kotë, pa bazë, pa argumente të sakta.

Dhe si i tillë hidhet poshtë dhe nuk lejohet të mirret në konsideratë.

Sidomos kur argumentet e sakta tregojnë të kundërtën.

● NDALESA PËRFSHIN SI NJË VARR, ASHTU EDHE DISA VARRE

Nëse xhamia ndërtohet qoftë edhe mbi një varr (si një apo si shumë varre), gjykimi është i njejtë.

● VENDI NË TË CILIN NDODHET VARRI NË XHAMI.

Nuk ka dallim, dhe nuk ndryshon gjykimi se në cilin vend të xhamisë gjendet varri.

Si në pjesën para, si në pjesën mbrapa dhe si anash. Apo qoftë edhe në holl të xhamisë, e njejtë është.

Madje edhe në oborr të xhamisë. Nëse oborri është i dedikuar që në fillim për xhaminë, ka gardh rrethues dhe derë nga ku hyhet dhe dilet.

Thotë Shejh Albani:

الأحاديث التي جاءت تنهى عن اتخاذ المساجد على القبور هي مطلقة لم تفرق بين أن يكون القبر في جهة القبلة أو في دبر القبلة أو في أي جهة أخرى.

"Hadithet të cilat ndalojnë bërjen e xhamive mbi varre janë të përgjithësuese, nuk bëjnë dallim ndërmjet të qenurit varri në anën e kibles apo, apo mbas, apo në çdo anë tjetër." -F-

[سلسلة الهدى والنور 543]

Thotë shejhu në të njejtën kasetë:

لا تجوز الصلاة في مسجد مبني على القبر ، و لا فرق بين يكون (في داخل المسجد مما يسمى بالحرم ، أو خارجه مما يسمى بصحن المسجد).

"Nuk lejohet namazi në një xhami e cila është ndërtuar mbi varr, dhe nuk ka dallim ndërmjet të qenurit varri, brenda xhamisë, apo jashtë xhamisë (në atë që e quajnë holli i xhamisë)." -F-

Holli i xhamisë është pjesa e zbuluar e saj.

● DALLIMI NDËRMJET XHAMISË E CILA ËSHTË NDËRTUAR MBI VARR, DHE XHAMISË E CILA ËSHTË FUTUR VARRI BRENDË PASI ËSHTË NDËRTUAR

Ka dijetarë të cilët bëjnë dallim ndërmjet xhamisë e cila është ndërtuar mbi varr, dhe xhamisë në të cilën është futur varri në të pasi është ndërtuar.

Prej dijetarëve që e bëjnë këtë dallim është shejkh Ibn Uttejmini All-llahu e mëshiroftë.

(7)

.....

■ ÇESHTJA E TRETË

NDËRTIMI XHAMIVE MBI VARR

(2)

● DALLIMI NDËRMJET XHAMISË E CILA ËSHTË NDËRTUAR MBI VARR DHE XHAMISË NË TË CILËN ËSHTË FUTUR VARRI PASI ËSHTË NDËRTUAR

**Ndërtimi i xhamive mbi varr është veprim i ndaluar (haram), madje haram i madh.
Ka mallkim për ata që e bëjnë këtë.**

Te kjo xhami:

- Ose duhet të nxirret i vdekuri dhe të varroset në varreza kur trupi akoma nuk është tretur.
Apo të nxirren eshtrat e tij nëse trupi është shpërbërë.
- Ose duhet të shembet xhamia.

Thotë shejh Bin Bazi All-llahu e mëshiroftë:

إذا وُجد في المسجد قبر وجب أن يُنْبَش و تنقل رفاتة الى المقبرة

"Nëse gjendet në xhami varr, është detyrë që eshtrat (çdo gjë që ka mbetur pas tretjes së trupit) të nxirren dhe të çohen në varreza."

Thotë:

أما ان كان القبر هو القديم و بني عليه مسجد وجب هدم المسجد و أن لا يصلی فيه ، و أنه لا يبقى ، بل يهدم؛ لأنه بني على معصية الله
"Nëse varri është i vjetër (dmth: ka qenë aty para ndërtimit të xhamisë) dhe është ndërtuar mbi të xhami, është detyrë të shembet xhamia.

Dhe nuk lejohet falja (namazi) në të, si dhe nuk lejohet të qëndroje xhamia, por duhet shembur, sepse është ndërtuar në kundërshtim të All-llahut." -F-

[El feteua El Bazijjeh]

Në rastin kur xhamia është ndërtuar si duhet, por më vonë është futur varr në të:

- kjo xhami nuk shembet, por duhet të nxirret i vdekuri nga aty, dhe të rrafshohet varri.
- Përveçse nëse ajo xhami synohet vetëm për t'iu lutur atij varri, atëherë duhet të shembet (dhe insha All-llahu nuk futet te dëmtimi i xhamisë, i vakëfit dhe pasurisë).

Sepse është frika se edhe nëse hiqet varri, ata do mendojnë se kanë ngelur gjurmët dhe bereqeti i tij.

Kështu që në këtë rast, e keqja e mos prishjes së kësaj xhamie është më e madhe se dëmtimi i xhamisë, i vakëfit dhe pasurisë.

All-llahu e di më së miri.

-- Dallimi tjetër është te namazi.

Ka prej dijetarëve që bëjnë dallim në lidhje me namazin në xhamitë të cilat janë ndërtuar mbi varr, dhe ato në të cilat është futur varri më pas.

(Do përmendet më poshtë)

● VARROSJA E TË VDEKURIT NË XHAMI

Varrosja e të vdekurit në xhami nuk lejohet, është haram.

Thotë Bin Bazi:

أما الدفن في المسجد فلا يجوز. يجب أن يكون القبور خارج المسجد ؛ لأن الدفن فيها يجعل القبور مساجد .

"Varrosja e të vdekurit në xhami nuk lejohet..."

Thotë: *"Sepse varrosja e të vdekurit në xhami i kthen varret në vendfalje (xhamia)." -F-*

[El Fetava El Bazijeh]

U pyet shejh Albani: *"A lejohet varrosja e shehidit në xhami?"*

Tha:

دفن الشهيد في المسجد لو كان مشروعاً لكان أولى بهذا المشروع دفن الأنبياء، و من المعلوم بطريق التواتر عن النبي صلى الله عليه وسلم أنه حرم تحريماً شديداً دفن الأنبياء و الأولياء و الصالحين في المساجد .

"Sikur të ishte e lejuar varrosja e shehidit në xhami, lejimi që të varrosen Profetët, eulijatë dhe të devotshmit në xhami, do ishte më parësore.

Por Profeti e ka ndaluar me ndalesë të ashpër varrosjen e Profetëve, e eulijave dhe të devotshmëve në xhamia (vendfalje)." -F-

Shënim: Sa i përket thënies 'filani Shehid' ka mospajtim. Më e sakta është se nuk lejohet t'i thuhet dikujt në veçanti filan shehid [Albani, Ibn Uthejmini, Feuzani, etj...]

Shejhu e ka përmend këtu si përgjigje e pyetjes, në kuptimin e përgjithshëm, dhe jo atë specifik dhe të veçantë, sepse shejhu është prej atyre që e konsiderojnë të ndaluar të specifikohet filan person që është vrarë në luftë si shehid.

Thotë Ibn Uthejmini All-llahu e mëshiroftë:

الدفن في المساجد نهى عنه النبي صلى الله عليه وسلم، و نهى عن إتخاذ المساجد على القبور و لعن من اتخذ ذلك... و لأن هذا وسيلة... إلى الشرك بالله

"Varrosja e të vdekurit në xhami nuk lejohet. Ka ndaluar Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem nga kjo.

Ai ka ndaluar të bëhen xhamitë mbi varre dhe e ka mallkuar atë që e bën këtë.

Sepse kjo gjë është rrugë (mjet, formë, mënyrë) që të shpie në shirk." -F-

[Fetava El Akideh f:26]

Xhamitë janë për All-llahun, që të adhurohet All-llahu, të falet namazi dhe të përmendet All-llahu.

Xhamitë nuk janë që të varrosen të vdekurit.

Thotë All-llahu:

((وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا))

Kuptimi:

((Me të vërtetë xhamitë janë për All-llahun (të adhurohet All-llahu dhe të përmendet ai).

Dhe mos adhuroni krahas All-llahut asnjë.))

Thotë Ibn Uthejmini:

فيجب أن تكون المساجد لله سبحانه وتعالى خالية من مظاهر الشرك

"Është detyrë që xhamitë të jenë vetëm për All-llahun. Të boshatisura nga çdo shfaqje e shirkut." -F-

--Pra, nuk lejohet varrosja në xhami e asnjë personi kushdo qoftë ai:
qoftë mbret, dijetar, i thjeshtë, apo personi që e ka bërë xhaminë.

--Nëse varrosja e dikujt në xhami bëhet:

- për t'a nderuar, si për shembull: mbretin apo personin që e ka bërë xhaminë, **kjo është haram i madh**.
- me pretendimin se ka qenë njeri i mirë, dhe varrosja e tij në xhami ia shton bereqetin vendit, dhe veprave të mira që bëhen në të, atëherë **ky është shirk i vogël**, dhe portë e madhe për te shirku i madh.
- me pretendimin se filani ndërmjetëson te All-llahu, ashtu që njerëzit t'i luten, **ky është shirk i madh** (All-llahu na ruajt).

Thjesht varrosja e të vdekurit në xhami nuk është shirk. Është haram i madh, por jo shirk.

Po ashtu thjesht ndërtimi i xhamisë mbi varr nuk është shirk. Është haram i madh, por jo shirk.

Nuk ka argument, dhe as fjalë dijetarësh që tregon se thjeshtë ndërtimi i xhamisë mbi varr është shirk, apo futja e varrit në xhami është shirk.
Është shirk vetëm në rastet që i përmenda më lart.

All-llahu e di më së miri.

-- Varrosja e te vdekurit në xhami përfshin të gjithë xhaminë, bashkë me hollin e tij dhe oborrin e tij.

● GJYKIMI I NAMAZIT NË NJË XHAMI NË TË CILËN KA VARR (1)

Nëse falet në një xhami në të cilën ka varr, me besim apo me pretendimin se në këtë xhami ka bereqet dhe mirësi më shumë se në xhamitë tjera, për shkak të varrit që gjendet në të, namazi i tij është i kotë, jo i saktë. I tilli del pa namaz, dhe obligohet t'a përsërite namazin.

Ky është mendimi i të gjithë dijetarëve Hanefi, Maliki, Shafii dhe Hanbeli.

Po ashtu është mendimi i të gjithë dijetarëve tjerë.

Thotë Shejh Ferkusi All-llahu e ruajt:

و لا يختلف أهل العلم فيمن جاء المسجد الذي يوجد فيه قبر -- أنه إذا صلى لأجل التبرك بالقبر أو اعتقاد أن للمسجد زيادة فضل بزيادة بركة المقبور-- أن الصلاة تبطل، قولا واحد من أهل العلم جميعا.

"Nuk ka mospajtim te dijetarët në lidhje me personin i cili vjen (për t'u falur) te xhamia në të cilën ka varr, me qëllim TEBER-RUKI (kërkim bereqeti) nëpërmjet varrit që gjendet në atë xhami.

Apo me besimin se kjo xhami ka mirësi më shumë se xhamitë e tjera, për shkak të varrit që gjendet në të, namazi i tij është i kotë, jo i saktë.

Kjo, me unanimitetin e të gjithë dijetarëve." -F-

Ndërsa ai i cili falet në një xhami në të cilën ka varr, duke mos patur aspak qëllim dhe synim varrin, por i gjithë synimi i tij është të fale namazin me xhemat. Në lidhje me namazin e tij ka mospajtim te dijetarët.

Shumica e dijetarëve e konsiderojnë të papëlqyer (Mekruh) namazin në një xhami në të cilën ka varr.

Ky është mendimi i Hanefive dhe Shafive.

Ndërsa Malikitë thonë: "Lejohet dhe nuk është Mekruh (e papëlqyer)."

ذهب جمهور العلماء الى أن الصلاة في المسجد الذي فيه قبر مكروهة و هو مذهب الحنفية و الشافعية و هو رواية عن أحمد و رواية عن مالك و ذهب المالكية الى الجواز من غير كراهة.

Këta i interpretojnë hadithet të cilat ndalojnë që të bëhen varret xhamia, me interpretime të ndryshme.

Prej tyre:

- Thonë disa: është për qëllim mos madhërimi.
- Disa thonë: është për qëllim mos bërja e tyre vend adhurimi.
Dhe bazohen në fjalën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem:
(اللهم لا تجعل قبري وثنا يعبد من دون الله. اشتد غضب الله على قوم اتخذوا قبور أنبيائهم مساجد)
(O All-llah mos lejo që varri im të bëhet idhull, (vend adhurimi), që të adhurohet pos All-llahut.
Është shtuar hidhërimi i All-llahut ndaj atyre njerëzve që i bëjnë varret e Profetëve vendfajle))
[Muetta, sahih - Albani]
- Disa tjerë thonë: është për qëllim mos bërja e tyre kible, që të falesh në drejtimin e varreve.
[El Mubarekfuri ne Tuhfetul eh' uedhi]

Këta bazohen në disa argumente, një pjesë prej të cilave i kam përmendur te Tema: "Falja namazit në varreza."

Hanbelitë thonë: "Nuk lejohet namazi në një xhami në të cilën ka varr."

و ذهب الحنابلة الى أن ذلك حرام و الصلاة باطلة
و هناك رواية عن أحمد أن ذلك حرام و الصلاة صحيحة
"Hanbelitë e konsiderojnë haram namazin në një xhami në të cilën ka varr.
E nëse falet, namazi është i kotë."

Në një transmetim, Imam Ahmedi thotë:

"Namazi është haram, ama nëse falet namazi është i saktë (nuk ka nevojë t'a përsërisë)."

Thotë Ibn Tejmije:

فالمسجد الذي على القبر لا يصلى فيه فرض و لا نفل فإنه منهي عنه
"Xhamia e cila është ndërtuar mbi varr, nuk lejohet namazi në të, as namaz farz dhe as vullnetare." -F-
[Mexhmu el fetava]

Thotë Ibnul kajjim All-Ilahu e mëshiroftë:

قال ابن القيم في [زاد المعاد] عن الصلاة في المسجد الذي فيه قبر: و لا يجوز و لا تصح الصلاة في هذا المسجد
"Nuk lejohet dhe as nuk është i saktë namazi në këtë xhami (në të cilën ka varr)." -F-

Thotë shejh Bin Bazi:

. الصلاة في المسجد الذي فيها القبر لا تصح
"Xhamia në të cilën ka varr, nuk është i saktë namazi në të." -F-

Thotë shejh Albani:

ينهى عن الصلاة في هذا المسجد (يعني في المسجد الذي فيه قبر)
"Është i ndaluar namazi në këtë xhami (në xhaminë në të cilën ka varr)." -F-

Dijetarët të cilët e ndalojnë faljen në xhaminë ku ka varr, janë ndarë në dy mendime në lidhje me saktësinë e namazit.

- Disa thonë: "Namazi është i kotë, jo i saktë." Ky është mendimi i shumicës prej tyre.
- Disa prej tyre thonë: "Namazi është i saktë, por me mëkat."

Shejh Albani duket sikur ka dy mendime.

Në një vend thotë: "Namazi nuk është i saktë."

ما تصح الصلاة في مسجد فيه قبر فيه اي كان القبر منه... لأن المسجد هذا بني على معصية الله
[متفرقات للالباني 268]

"Nuk është i saktë namazi në një xhami në të cilën ka varr, sepse kjo xhami është ndërtuar në kundërshtim të All-Ilahut." -F-

Në një vend tjetër thotë: "Namazi është i saktë."

أما القول ببطلان الصلاة فيه دون قصد، فليس عليه نهي خاص يمكن الاعتماد عليه، و لا يمكن أن يقاس عليه قياسا صحيحا، و لعل هذا هو السبب في ذهاب الجمهور الكراهة دون البطلان.

"Sa i përket mendimit se namazi në të (dmth: në xhaminë ku ka varr) është i kotë (jo i saktë), nuk ka ndalesë specifike në të cilën mund të mbështetemi.

Dhe as nuk mund të bëjmë krahasim (analogji) të saktë,

Dhe mbase kjo është arsyeja se pse shumica e dijetarëve mendojnë që namazi është i saktë." -F-

[Tehdhir Esseexhid]

- Disa dijetarë tjerë bëjnë dallim ndërmjet xhamisë e cila është ndërtuar mbi varr dhe xhamisë në të cilën është futur varri më pas (pasi është ndërtuar).

Thotë Ibn Uthejmini:

الصلاة في المسجد فيه قبر على نوعين

الاول: أن يكون القبر سابقا على المسجد بحيث بني المسجد على القبر، فالواجب هجر هذا المسجد و عدم الصلاة

و النوع الثاني: أن يكون المسجد سابقا على القبر بحيث يدفن الميت فيه بعد المسجد ، فالواجب نبش القبر و إخراج الميت منه ودفنه مع الناس، أما المسجد فتجوز الصلاة فيه بشرط أن لا يكون القبر أمام المصلي لأن النبي صلى الله عليه وسلم نهى عن الصلاة الى القبور

[مجموع فتاوى ابن عثيمين م، ١٢]

"Namazi në një xhami në të cilën ka varr është dy lloje:

- *Kur varri ka qenë para se të ndërtohet xhamia, dhe xhamia është ndërtuar mbi të. Në këtë rast është detyrë bojkotimi i kësaj xhamie, dhe mos falja aty.*
- *Kur xhamia është para varrit, dhe i vdekuri është varrosur aty pasi ishte ndërtuar xhamia. Në këtë rast është detyrë zhvarrosja dhe nxjerrja e të vdekurit nga varri dhe xhamia, dhe varrosja e tij me njerëzit e tjerë, ndërsa namazi lejohet të falet në këtë xhami (nëse nuk e heqin varrin), me kusht që varri të mos jetë para atij që falet, sepse Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka ndaluar që të falet namazi në drejtim të varrit."* -F- [Mexhmu fetava Ibn Uthejmini v.12]

Thotë:

إذا كان المسجد مبنيًا على القبر فالصلاة فيه لا تصح لأن هذا المسجد محرم و يجب هدمه

وإذا كان المسجد سابقا و دفن فيه ميت فينظر: إذا كان القبر في جهة القبلة فإنه لا يصلى في هذا المسجد لأن النبي صلى الله عليه و سلم قال ((لا تصلوا الى القبور))

و أما إذا كان على يمين مستقبل القبلة أو يساره أو خلف ظهره فلا بأس

"Nëse xhamia është ndërtuar mbi varr, atëherë namazi në të nuk është i saktë, sepse kjo xhami është ndërtuar në kundërshtim të All-llahut, dhe është detyrë shembja e saj.

E nëse xhamia është ndërtuar përpara, dhe i vdekuri është varrosur në të më pas, në këtë rast shohim:

Nëse varri është nga ana e kibles, nuk lejohet falja në këtë xhami, sepse Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë: ((mos u falni në drejtim të varreve)).

E nëse është nga ana e djathtë e tij apo e majta, apo nga mbas tij, nuk ka problem." -F-

Thotë shejhu në [Silsiletu likail Meftuh 020-b]:

إذا كان القبر بين يديك فلا تصل

و اذا كان القبر خلف ظهرك أو عن يمينك أو عن شمالك فينظر هل القبر سابق على المسجد، ام أن المسجد بني عليه، و في هذه الحالة لا تصل أيضا،

و إن كان المسجد سابقا على القبر فصلّي

"Nëse varri është para teje mos u fal.

E nëse varri është pas teje, apo në të djathtën tënde, apo në të majtën tënde, atëherë shikohet:

Nëse varri ka qenë përpara xhamisë dhe xhamia është ndërtuar mbi varr, në këtë rast mos u fal.

E nëse xhamia është ndërtuar përpara varrit, në këtë rast falet namazi (dmth: lejohet të falet namazi në këtë xhami)."-F-

Pra, në mendimin e shejhut, nëse xhamia është ndërtuar mbi varr, namazi nuk lejohet.

E nëse xhamia është ndërtuar përpara varrit, dhe personi është varrosur në të pasi është ndërtuar xhamia, lejohet falja e namazit.

Po ashtu, shejhu dhe ata që e kanë këtë mendim, bëjnë dallim në lidhje me vendin në të cilin ndodhet varri në xhami:

Nëse varri është në anën e kibles, para atij që falet, nuk lejohet namazi.

E nëse falet, namazi nuk është i saktë (është detyrë t'a përsërite).

E nëse është djathtas, apo majtas, apo mbas, lejohet namazi.

Shumica e dijetarëve që e ndalojnë namazin në xhaminë në të cilën ka varr, nuk bëjnë dallim ndërmjet xhamisë e cila është ndërtuar mbi varr, dhe xhamisë në të cilën është futur varri pasi është ndërtuar xhamia.

Si dhe, nuk bëjnë dallim në lidhje me vendin ku ndodhet varri, në raport me saktësimin e namazit.

Thotë shejh Albani:

الأحاديث التي جاءت تنهى عن اتخاذ المساجد على القبور هي مطلقة لم تفرق بين أن يكون القبر في جهة القبلة أو في دبر القبلة أو في أي جهة أخرى.

"Hadithet të cilat ndalojnë bërjen e vendfaljeve (xhamive) mbi varre, janë përgjithësuese. Nuk bëjnë dallim ndërmjet varrit i cili ndodhet në anën e kibles, apo nga ana e pasme, apo nga çdo anë tjetër." -F-

[Silsiletul Hude uen Nur 543]

Që do të thotë se: në ç'farëdo ane të xhamisë qoftë varri, nuk lejohet namazi.

Ama nëse varri ndodhet nga ana e kibles, mëkati pa dyshim që është më i madh.

Thotë shejh Albani:

لكن إذا كان الصلاة في المسجد المبني على القبر هي موجهة إلى جهة القبر أيضا فتكون معصية مضاعفة، المعصية الأولى حيث يصلي في مسجد فيه قبر، والمعصية الأخرى حيث يَتَوَجَّهُ بصلاته إلى القبر.

"Nëse namazi në xhaminë e ndërtuar mbi varr, është në drejtim të varrit, mekati është dyfish:

Mëkati i parë: që po falet në një xhami në të cilën ka varr.

Dhe mëkati tjetër : që po falet në drejtim të varrit."

[متفرقات للالباني 268]

● GJYKIMI I NAMAZIT NË NJË XHAMI NË TË CILËN KA VARR (2)

Thotë shejh Albani All-Ilahu e mëshiroftë:

، ففي هذه النقول ما يؤيد ما ذهبنا اليه من كراهة الصلاة في المساجد المبنية على القبور مطلقا، سواء صلى إليها أو لا ، فيجب التفريق بين هذه المسألة و بين الصلاة الى القبر الذي ليس عليه مسجد ، ففي هذه الصورة إنما تحقق الكراهة عند استقبال القبر.

"Këto transmetime e përforcojnë mendimin tonë që është se: qortueshmëria e namazit në xhamia të ndërtuara mbi varre është e përgjithshme, si në rastin kur falesh në drejtim të varreve, dhe si në rastin kur nuk falesh në drejtim të tyre (për sa kohë që varri ndodhet në xhami).

Dhe është detyrë të bëhet dallim ndërmjet kësaj çështje (dmth: namazit kur varri është në xhami), dhe namazit në drejtim të varrit (në vend të hapur) mbi të cilin nuk është ndërtuar xhami. Në këtë rast, qortueshmëria qëndron te kthimi në drejtim të varrit." -F-

[Tehdhir Essexhid]

Dmth: qortueshmëria e faljes në xhami në të cilën ka varr, qëndron në faktin se në xhami gjendet varr, dhe jo në faktin se në cilën anë të xhamisë ndodhet varri.

Pra, përderisa varri gjendet në xhami (në ç'farë do anë të xhamisë qoftë ai), është i qortuar namazi në xhami, sepse ti po falesh në një vend ku ka varr, dhe nuk ka të bëjë se në cilën anë të atij vendi ndodhet varri.

Ndërsa, kur varri ndodhet në vend të hapur, jo në xhami, qortueshmëria qëndron te falja në drejtim të varrit.

-Falja në drejtim të varrit në këtë rast është për qëllim: kur ndërmjet teje dhe kibles ka varr, ama kur personi falet nga varri dhe jo nga kibla, kjo në këtë rast është shirk (e kam përmend fjalën e shejh Albanit në lidhje me këtë).

E nëse varri është nga e djathta apo e majta e atij që falet, apo mbas tij, nuk është i qortueshëm namazi.

Varri duhet të jetë larg, jo ngjitur. Nëse është larg nuk ka problem.

Ama nëse varri është ngjitur, edhe pse është majtas, apo mbas teje nuk lejohet namazi, sepse po falesh te varri, në një vend ku ka varr, dhe falja në një vend ku ka varr nuk lejohet.

Ky është kuptimi i fjalës së shejh Albanit.

Fjala e Shejhut: "E QORTUESHME"

nuk është për qëllim MEKRUHU (e pa pëlqyer), dmth: nuk është haram, jo.

Por me këtë term shejhu ka për qëllim atë që njihet te Selefi në përgjithësimin e fjalës (termit) Mekruh: Kur ata e përgjithësojnë, kanë për qëllim atë ç'farë është e ndaluar (Haram).

Me argumentin se shejhu në shumë vende tjera (libra dhe audio) e konsideron të ndaluar faljen në xhaminë në të cilën ka varr.

Thotë shejh Albani:

ما تصح الصلاة في مسجد فيه قبر في أي مكان كان القبر منه.

"Nuk është i saktë namazi në një xhami në të cilën ka varr, në ç'farëdo vendi të xhamisë qoftë varri..

Thotë:

إذا كان الصلاة في المسجد المبني على القبر هي موجهة إلى جهة القبر أيضا فتكون المعصية مضاعفة،

....المعصية الأولى حيث يصلي في مسجد فيه قبر

"Nëse personi në xhaminë e cila është ndërtuar mbi varr, falet në drejtim të varrit (dmth: varri është nga ana kibles), mëkati është dyfish:

Mëkati i parë është: falja e tij në xhami në të cilën ka varr.

Mëkati tjetër është: kur falet në drejtim të varrit." -F-

[متفرقات للألباني 268]

Thotë shejhu:

أن النهي عن الصلاة في المساجد المبنية على القبور كالنهي عن الصلاة في الأوقات المحرمة

"Ndalesa e faljes së namazit në xhamia të ndërtuara mbi varre, është si ndalesa e namazit në kohët e ndalura."

[Silsiletul hude uen- nur 543]

Këto fjalë të shejhut deshmojnë se: në mendimin e shejh Albanit nuk lejohet falja në xhaminë ku ka varr

- Disa dijetarë e lejojnë faljen në xhaminë e cila ka varr, por me kusht

Nëse ka xhami tjetër dhe ka mundesi me shku te ajo, nuk i lejohet me u fal në këtë xhami ku ka varr.

E nëse nuk ka, apo ka, por nuk e arrin dot, atëherë i lejohet t'a fale namazin me xhemat në këtë xhami ku ka varr.

Thotë Shejh Albani:

الذي يقصد المسجد من أجل القبر فلا شك بأنه لا صلاة له

،أما من يصلي في هذا المسجد و ليس في باله أبدا أنه يصلي فيه من أجل القبر ، فصلاته صحيحة

لكن ينهى عن الصلاة في هذا المسجد ؛ لأنه النهي عن الصلاة في المسجد الذي فيه قبر هو من باب سد الذريعة ، كالنهي عن الصلاة في الأوقات المكروهة

"Ai i cili synon xhaminë (shkon për t'u falur) për shkak të varrit, pa dyshim që nuk ka namaz (dmth: nuk është i saktë namazi i tij. Obigohejt t'a përsërite).

Ndërsa ai i cili falet në atë xhami, duke mos menduar aspak se po shkoj të falem për shkak të varrit, namazi i tij është i saktë." -F-

Thotë shejhu:

فأنا أرى استنباطا و اجتهادا أن المسجد المبني على القبر أنه يمكن أن تجوز الصلاة فيه في بعض الظروف الاستثنائية مثلا :بينما رجل يمشي في طريقه الى داره الى عمله .إذا به يسمع الأذان و هو يعلم أن هذا المسجد فيه قبر ، و أنه يجب عليه أن لا يقصد هذا المسجد بالصلاة فيه ، لكن هو بين أن يدخل و يصلي فيه و بين أن تفوته صلاة الجماعة

، فإذا دار الأمر بين هذين الأمرين تغلب وجوب فريضة صلاة الجماعة على تحريم الصلاة في المسجد المبني على القبر ، ذلك لأن النهي عن الصلاة في المسجد المبني على القبر من باب سد الذريعة ، كما أن الصلاة في الأوقات المكروهة من باب سد الذريعة ، لكن إذا أدركه الوقت و لم يكن هناك إمكان إلا أن يدع الصلاة حتى يخرج الوقت كله أو أن يصلي في الوقت الكراهة ، هذا أولى من أن يُضَيِّع الصلاة بالكلية ، كذلك إذا دار الأمر بين أن يضيق فريضة صلاة الجماعة و بين أن يصلي في مسجد الكراهة ، فُجِّحَت الصلاة في هذا المسجد على أن يصلي وحده في بيته أو في مكان آخر ، هذا بطبيعة الحال معناه أو هذه الصورة إنما نعني بها أنه إذا لم يكن في علمه أو لم يكن في استطاعته أن يدرك الصلاة مع الجماعة في هذا مسجد آخر ليس فيه قبر....

و هذا يجب أن نلاحظه لأنني أعرف بتجربتي الخاصة أن كثيراً من إخواننا السلفيين لا يلاحظون هذا التفريق ، فبُجِّدَ أن يعلموا أن مسجداً فيه قبر ، لا يصلون فيه ، و لو فاتتهم صلاة الجماعة ، هذا خطأ.

[سلسلة الهدى و النور 543]

"Në disa raste (situata), mundet që të lejohet namazi në një xhami e cila është e ndërtuar mbi varr.

Për shembull: është duke ecur rrugës për në shtëpi, apo për në punë, dhe dëgjon ezanin. Ky e di se në këtë xhami ka varr, si dhe e di që nuk lejohet falja në këtë xhami, por në këtë rast ky ose do futet të falet, ose do i ike namazi me xhemat.

Në këtë rast, obligimi i faljes së namazit me xhemat në xhami e mund ndalesën e faljes në një xhami të ndërtuar mbi varr (dmth: është më parësore).

Kjo, sepse ndalesa e faljes në xhami të ndërtuar mbi varr është për shkak të mbylljes së çdo shtegu (rruge dhe mjeti) që të shpie në haram (në rastin konkret: në shirk).

Ashtu sikurse ndalesa e faljes në kohët e ndaluara është për shkak të mbylljes së çdo rruge (që të shpie në shirk).

(Dmth: nuk është haram në vetvete, sepse nuk është haram të falesh, por ndodh që nëse falesh në një kohë të caktuar, apo vend të caktuar mund të bëhet mjet dhe rrugë që të shpie në shirk, prandaj e ndalon sheriatu, si rastin për të cilin po flitet.)

Nëse e kap koha (kur nuk lejohet namazi në atë kohë) dhe nuk ka zgjidhje tjetër përpos t'a lëre namazin derisa të dale koha, ose të falet në kohë të ndaluar, falja në kohë të ndaluar, në këtë rast, është më parësore, sesa t'i humbe namazi me xhemat.

Kështu edhe në rastin kur ai është në situatën që:

- Ose do t'a humbe namazin me xhemat.
- Ose do t'a fale atë në xhami ku ka varr.

Në këtë rast, më parësore është të falet në këtë xhami, sesa të falet vetëm në shtëpinë e tij apo diku tjetër.

Dhe natyrisht këtu kemi për qëllim rastin kur ai nuk di (ndonjë xhami tjetër), apo nuk mundet me e arrit namazin me xhemat në një xhami tjetër ku nuk ka varr..

Kësaj çështje duhet t'i kushtojmë kujdes (vëmendje)!

Sepse nga përvoja ime personale e di se, shumë prej vëllezërve tanë selefij nuk i kushtojnë kujdes (vëmendje) kësaj ndarje (ndërmjet faljes në xhami ku ka varr me qëllim që të kapësh namazin me xhemat dhe mos faljes). Sapo të informohen se në këtë xhami ka varr, (distancohen) nuk falen aty, edhe pse iu humb namazi me xhemat. Kjo është gabim." -F-

[Silsiletul Hude uen nur 543]

Pra, shejhu ka mendimin se: nëse nuk ke mundësi t'a arrish (kapësh) namazin me xhemat në një xhami tjetër ku nuk ka varr, atëherë lejohet t'a falësh namazin me xhemat në këtë xhami ku ka varre. Kjo është më mirë sesa të falesh vetëm.

Kjo, sepse ndalesa është e llojit 'ndalesë si pasojë, si mjet' (dmth: mbyllje e rrugës që të shpie në haram, apo shirk). Dhe nuk është ndalesë në vetvete.

Këto lloj ndalesash siç thotë shejhu, por edhe dijetarë tjerë para tij si Ibn Tejmije, Ibnul Kajjimi etj. lejohen në raste të nevojshme, apo të dobishme.

Thotë Ibn Tejmije:

النهي إذا كان لسد الذريعة أبيع للمصلحة الراجحة.

"Ndalesa e cila është mbyllje e rrugës që të shpie te harami (ndalesa si pasojë, si mjet) lejohet në raste dobie (kur dobia është më e madhe se dëmi)." -F-

Mendimi më i përafërt është:

Nuk lejohet falja në një xhami ku ka varr brenda saj, pa përjashtim.

Përpos në rastin kur nuk e kap dot namazin me xhemat diku tjetër, dhe ke frikë se të ikën, atëherë lejohet të falesh në këtë xhami.

Por me kushtin që: mos të jetë varr të cilin e adhurojnë përpos All-llahut. Ku bëhet tauaf rreth tij, apo luten te ai, apo ç'farëdo lloj adhurimi i cili bëhet i hapur.

Kjo xhami në këtë rast më shumë merr formën e një vend shirku, sesa vend ku adhurohet All-llahu.

Gjë tjetër plus, Imami i bie të jetë dakort me shirkun e tyre, përderisa hesht, dhe rri aty. Kjo e vë në pikëpyetje të madhe faljen pas tij.

All-llahu e di më së miri.

Kjo sa i përket namazit në një xhami në të cilën ka varr.

● GJYKIMI I NAMAZIT NË NJË XHAMI PËRRETH SË CILËS KA VARRE.

Varret të cilat ndodhen përreth një xhamie:

- Ose janë varre të cilat gjenden aty që para se të ndërtohet xhamia.
- Ose janë varre të vendosura pasi është ndërtuar xhamia.

Xhamia e cila është në mes të varreve (të cilat gjenden aty që para ndërtimit të xhamisë), ekziston frika që kjo xhami është ndërtuar mbi varre.

Shejh Albani thotë:

"Një xhami e cila është ndërtuar ndërmjet varreve, dhe ato varre janë para ndërtimit të xhamisë, vështirë të mendohet se është lënë një vend bosh, dhe të vije dikush më vonë të ndërtojë një xhami aty. Frika është se, ajo xhami është ndërtuar mbi varre. Megjithatë kjo çështje kthehet te banorët e atij vendi të cilët e njohin historikun e atyre varreve." -F-

Në përgjithësi varret të cilat ndodhen përreth xhamive, janë vendosur (apo gjenden aty) pas ndërtimit të xhamisë.

Mund të ketë ndonjë rast që varret kanë qenë aty para ndërtimit të xhamisë.

Ose ndodh që ka patur varre aty, dhe më vonë është ndërtuar xhamia afër varreve dhe pastaj me kalimin e kohës janë shtuar varret në anët tjera të xhamisë.

Në shumicën e rasteve varret të cilat i shohim përreth xhamive, janë vendosur pas ndërtimit të xhamive.

Thotë shejh Bin Bazi:

لأن هذا عادة جارية في كثير من البلدان يدفنون حول المساجد ، فلا يضرها ذلك شيئاً ، وقال رحمه الله : و المقصود أنه الدفن حول المساجد لا بأس به ؛ لأنه أسهل على الناس ، فإذا خرجوا من المسجد دفنوه حول المسجد ، فلا يضر ذلك شيئاً . و لا يؤثر في صلاة المصلين [مجموع فتاوى الشيخ ابن باز 13 / 357]

"Eshte zakon në shumë vende që të vdekurit varrosen përreth xhamisë.

Varrosja e njerëzve përreth xhamisë nuk ka problem, sepse është më e lehtë për njerëzit, (pasi kanë falur xhenazen në xhami) dalin nga xhamia dhe e varrosin rreth xhamisë.

Kjo nuk dëmton aspak, dhe as nuk ndikon në namazin e namazlive." -F-

- Në lidhje me gjykimin e namazit në një xhami përreth së cilës ka varre, ka mospajtim te dijetarët.

--Disa thonë: Nëse varret janë afër xhamisë dhe nuk ka mur apo rrugë që i ndan nga xhamia, namazi në atë xhami nuk lejohet dhe nuk është i saktë.

U pyet shejh Feuzani All-Ilahu e ruajt: në rastin kur varret janë afër xhamisë përafërsisht një metër?

قال الشيخ : هذه متصلة (بالمسجد) ، لا يجوز الصلاة في هذا المسجد ، إنما تجوز لو كان المقبرة مفصولة عن المسجد ، مفصولة بالشارع بساحة من الارض ... أما إذا كان الجدار واحد ، هذا اتصال و لا يجوز

[حكم الصلاة في مسجد بينه و بين المقبرة جدار صالح الفوزان]

"Këto varre konsiderohen të ngjitura me xhaminë, dhe si e tillë, nuk lejohet namazi në këtë xhami. Lejohet namazi në këtë xhami nëse varret janë të ndara nga xhamia me rrugë, apo ndërmjet tyre ka hapësirë (fushë, tokë të gjerë). Ama nëse është vetëm një mur (shejhu ndoshta ka për qëllim: vetëm murin e xhamisë), në këtë rast konsiderohen të ngjitura me xhaminë, dhe nuk lejohet namazi në këtë xhami." -F-

Thotë shejh Feuzani:

. إذا كان بينهما سوق أو طريق أو أرض فضاء ؛ فلا علاقة للمسجد بالقبر ، فصل في هذا المسجد أما إذا كان القبر ما بينه وبين المسجد إلا الجدار فقط لا تصح الصلاة في هذا المسجد؛ لأن النبي صلى الله عليه وسلم نهى عن الصلاة عند القبور.

"Nëse ndërmjet varreve dhe xhamisë ka treg, rrugë apo tokë të hapur të gjerë, në këtë rast xhamia nuk ka lidhje (nuk është e ngjitur) me varrin, kështu që falu në këtë xhami. Ama, nëse ndërmjet varrit dhe xhamisë ka vetëm një mur, atëherë namazi në këtë xhami nuk është i saktë, sepse Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka ndaluar të falet namazi në varreza." -F-

-- Disa dijetarë tjerë bëjnë dallim ndërmjet varreve që ndodhen anash xhamisë, dhe varreve që ndodhen para xhamisë nga ana e kibles.

Thotë Bin Bazi All-llahu e mëshiroftë:

، ما دام المسجد مقاما ما يضر كون القبور عن يمينه و شماله ما يضره ، يصلون في ذلك و لا حرج عليهم .
،و إذا كانت القبور قريبة من جهة الغرب الى القبلة فينبغي أن يكون بين المسجد و بين القبور جدار آخر تحجز المقبرة عن المسجد . هذا هو الأولى و الأكمل .
"Përderisa xhamia është ndërtuar, varret që ndodhen nga e djathta dhe e majta e saj nuk dëmtojnë, le të falen në atë xhami, nuk ka problem. Ama, nëse varret janë afër xhamisë nga ana e kibles, duhet që të bëhet një mur tjetër ndërmjet xhamisë dhe varreve, që të ndaje varrezat nga xhamia. Kjo është më parësore dhe më e plotë."

Thotë:

أما إن كانت عن يمين المسجد أو عن شماله أي: عن يمين المصلين أو عن شمالهم فلا يضرهم شيئا ؛ لأنهم لا يستقبلونها .
"Ama, nëse varret janë nga ana e djathtë apo e majtë e xhamisë, dmth: nga ana e djathtë e namazlive dhe e majta e tyre, kjo nuk i dëmton gjë (nuk ka problem), sepse ata nuk po falen në drejtim të varreve."
[El Fetawa El Bazijje. binbaz.org]

Thotë Ibn Uthejmini All-llahu e mëshiroftë:

...إذا كانت القبور في القبلة فإن الأمر أشد، و لو لا جدار المسجد الذي يحول بين المسجد و بين القبور لقلنا :إن الصلاة لا تصح
"Nëse varret janë nga ana e kibles, çeshtja është më e rëndë. Po të mos ishte muri i xhamisë, i cili bën ndarjen ndërmjet xhamisë dhe varreve, do thonim që namazi nuk është i saktë." -F-

● MURI NDËRMJET XHAMISË DHE VARREVE

Sa i përket murit ndërmjet xhamisë dhe varreve ka mospajtim te dijetarët.

Thotë Ibn Uthejmini:

أما القبور التي بينها وبين المسجد جدار المسجد فمن العلماء من قال إنه لا يصح ، لا تصح الصلاة و لا يجوز أن يُبنى قبر أمام المسجد على هذا الوجه.

،و بعض العلماء يقول :يصح ، و ذلك لأن الذي يصلي في داخل المسجد لا يرى قبورا يصلي إليها ،و الصحيح أنه للحاجة و الضرورة لا بأس به .

سئل :و الذي في المؤخرة يا شيخ ؟

..قال :لا .الذي في المؤخرة لا يضر ، إلا إذا كان المسجد مبنيا على القبور

"Në rastin kur varret dhe xhamia ndahen mes tyre vetëm nga muri i xhamisë:

- Disa dijetarë thonë: Namazi nuk është i saktë.
- Disa dijetarë tjerë thonë: Namazi është i saktë, sepse ai i cili falet brenda xhamisë nuk i shikon varret drejt të cilave po falet.

Mendimi më i saktë është se: në raste nevoje dhe domosdoshmërie nuk ka problem (falja në këtë xhami e cila ndahet nga varret, vetëm nga muri i xhamisë)." -F-

U pyet shejh Bin Bazi në lidhje me një xhami e cila ndodhet në mes të varreve. Varret e rrethojnë nga e djathta dhe e majta e saj, dhe distanca ndërmjet varreve dhe xhamisë është dy metra.

سئل ابن باز عن مسجد يقع وسط المقابر التي تحيط به من الشمال و الجنوب ط، و المسافة بينه و بين الجهة الشمالية متران، و كذلك الجنوبية متران ؟

،فأجاب الشيخ رحمه الله تعالى :لا حرج في بقاء المسجد المذكور لأن العادة جارية أن الناس يدفنون حول المساجد، فلا يضر ذلك شيئا، و المقصود أنه الدفن حول المساجد لا بأس به ؛ لأنه أسهل على الناس، فإذا خرجوا من المسجد دفنوه حول المسجد، فلا يضر ذلك شيئا، ولا يؤثر في صلاة المصلين، لكن إذا كان في قبلة المسجد شيء من القبور فالأحوط أن يكون بين المسجد و بين المقبرة جدار آخر غير جدار المسجد، أو طريق يفصل بينهما ، هذا هو الأحوط و الأولى ليكون ذلك أبعد عن استقبالهم للقبور [مجموع فتاوى الشيخ ابن باز 13/357]

Thotë shejhu:

و الظاهر انه لا يضر ذلك شيئا لأن هذا عادة جارية في كثير من البلدان يدفنون حول المساجد فلا يضر ذلك شيئا، المقصود أن من عادة بعض الناس في بعض البلدان انهم يدفنون حول المساجد لأنه أسهل عليهم اذا خرجوا من المسجد دفنوا حول المساجد فلا يضر ذلك شيئا و لا يؤثر في صلاة المصلين،

لكن إذا كان في قبلة المسجد شيئا من القبور فالأحوط أن يكون بين المسجد و بين المقبرة جدار آخر غير جدار المسجد، هذا هو الأحوط و الأولى ليكون أبعد عن استقبالهم للقبور.

"Qëndrimi i xhamisë së përmendur (aty ku është) nuk është problem.

Është zakon në shumë vende që njerëzit t'i varrosin përreth xhamisë.

Varrimi i njerëzve përreth xhamive nuk ka problem; për shkak se është më e lehtë për njerëzit (pasi kanë falur namazin e xhenazes), dalin nga xhamia dhe e varrosin rreth xhamisë. Nuk ka problem në këtë gjë, dhe as nuk ndikon në namazin e namazlive.

Por, nëse nga ana e kibles ka varre, më e mira dhe më larg dyshimit është që të bëhet një mur tjetër plus murit të xhamisë ndërmjet varreve dhe xhamisë, apo një rrugë e cila ndan varret nga xhamia. Kjo është më parësore, ashtu që me këtë të jenë më larg drejtimit nga varret." -F-

[[Shejhu me murin e xhamisë ka për qëllim xhaminë si ndërtesë objekti, dhe jo murin rrethues.

Që mos të këqkuptohet]]

Thotë shejhu në një tjetër fetwa:

إذا كانت القبور قريبة من جهة الغرب الى القبلة فينبغي أن يكون بين المسجد و بين القبور جدار آخر تحجز المقبرة عن المسجد، هذا هو الأولى و الأكمل.

"Nëse varret janë afër xhamisë nga ana kibles, duhet që ndërmjet xhamisë dhe varreve të bëhet një mur tjetër (plus murit të xhamisë si ndërtesë) që të ndaje varret nga xhamia. Kjo është më parësore dhe më e plotë." -F-

Në një fetwa tjetër thotë:

و الواجب ان يكون مفصولا بينهما بجدار حتى لا يصل إلىهما.

"Është detyrë që të jenë të ndara ndërmjet tyre (xhamia nga varret) ashtu që mos të falen ne drejtim të varreve." -F-

Shejhu këtu ka për qëllim murin e xhamisë (All-llahu e di më së miri), dhe jo mur tjetër plus murit të xhamisë. Kjo duke u bazuar në fetwat e tjera të shejhut ku shprehet qartë se: 'muri tjetër plus murit të xhamisë është më mirë, me parësor, më e plotë dhe më larg dyshimit. Që do të thotë se nuk është detyrë.

Dikush mund të thotë: "Si mund të jetë muri i xhamisë, ndarës, ndërmjet xhamisë dhe varreve, ku vetë muri është pjesë e xhamisë?"

Duhet të dimë se:

Xhamia konsiderohet xhami edhe nëse nuk është ndërtesë, por thjesht një tokë e destinuar -vakëf- për xhami, në formë të përhershme, edhe nëse është e rrethuar me gardh.

Thotë Ibn Uthejmini:

فالمسجد: ما أعد للصلاة فيه دائما و جعل خاصا بها ، سواء بني بالحجارة و الطين و الاسمنت .ام لم يُبْنِ

"Xhami është ajo (tokë, vend) që është lënë, veçuar -destinuar- që të falet namazi aty përgjithmonë (jo përkohësisht).

Si në rastin kur ndërtohet me gurë, apo me baltë, apo me çiment, apo e pandërtuar (jo ndërtesë)." -F-

Dmth: nuk është kusht të jetë ndërtesë, edhe nëse është e rrethuar me gardh, apo ka mbulesë me kashtë, të ngritur mbi shtylla druri, siç ka akoma në disa vende të varfëra.

● Disa dijetarë tjerë e konsiderojnë obligim bërjen e një muri tjetër plus murit të xhamisë që të bëjë ndarje ndërmjet murit të xhamisë dhe varreve nga ana e kibles.

Thotë shejh Albani:

يقول الإمام أحمد : (بأن المقبرة إذا كانت قبلي المسجد لا يكفي أن يكون جدار المسجد هو فاصلا بين المسجد و بين القبر، بل لا بد من بناء جدار آخر يفصل جدار المسجد عن القبور.

[فتاوى عبر الهاتف و السيارة 112]

"Thotë Imam Ahmed:

Nëse varrezat ndodhen para xhamie nga ana e kibles, nuk mjafton vetëm muri i xhamisë si ndarje ndërmjet xhamisë dhe varrit, por duhet medoemos të bëhet një mur tjetër i cili ndanë ndërmjet murit të xhamisë dhe varreve." -F-

U pyet shejh Albani në lidhje me një varr që ndodhet para xhamisë nga ana e kibles, në këtë varr kanë mbledhur dhe futur në të eshtrat e varreve që kanë qenë në territorin e xhamisë?

Tha shejhu:

لكن هذا القبر الذي جمعت فيه تلك العظام و هو في قبلي المسجد فينبغي أن يفصل بين جدار المسجد و بين القبر بجدار آخر

"Ky varr në të cilin kanë mbledhur dhe futur eshtrat, i cili ndodhet para xhamie nga ana kibles, duhet që të bëhet ndarje ndërmjet murit të xhamisë dhe varrit, me një mur tjetër." -F-

Thotë në një fetwa tjetër:

أنا أقول: يجب أن يكون فيه جدار يفصل بين القبر و بين جدار المسجد

[فتاوى عبر الهاتف و السيارات 117]

"Është obligim që të ketë një mur tjetër i cili bën ndarje ndërmjet varrit dhe murit të xhamisë." -F-

Shumica e dijetarëve nuk e konsiderojnë obligim bërjen e këtij muri.

All-llahu e di më së miri.

Personalisht anoj (por jo plotësisht) te ajo që: bërja e këtij muri nga ana e kibles është obligim, sidomos kur varret janë shumë afër xhamisë.

▪ Ndërsa, nëse muri i xhamisë është i shkurtër aq sa ai që falet në xhami i sheh varret para vetes, në këtë rast, ndërtimi i këtij muri është obligim.

All-llahu e di më së miri.

▪ **Sa i përket namazit:**

Mendimi i atyre që thonë se "namazi është i saktë", është mendimi me i përafërt.

Pra, si në rastin kur ka mur tjetër plus murit të xhamisë, dhe si në rastin kur nuk ka mur tjetër plus murit të xhamisë, namazi është i saktë. Sepse:

- Nuk ka argument që nuk e lejon namazin në këtë xhami dhe që e konsideron atë të pasaktë. Argumentet ndalojnë faljen në varreza. Xhamia nuk është në varreza. Varret janë të vendosura aty pas ndërtimit të xhamisë.
- Argumentet ndalojnë faljen në drejtim të varreve. Në këtë rast muri i xhamisë bën ndarje ndërmjet namazliut dhe varrit, dhe nuk konsiderohet që po falet në drejtim të varreve.

Përveçse nëse muri i xhamisë është i shkurtër, aq sa ai që po falet i sheh varret. Në këtë rast nuk lejohet namazi në këtë xhami, dhe nuk është i saktë, përpos nëse nuk ka xhami tjetër. Vetëm në këtë rast lejohet falja e farzit në këtë xhami.

▪ Ndërsa, nëse varret janë nga e djathta e xhamisë apo e majta, apo mbrapa saj nga ana e kundërt e kibles, **(si rasti i xhamisë Et' hem Beu në qendër)**, çështja është më e lehtë.

Bërja e murit tjetër në këtë rast është e pëlqyer.

Ndërsa **namazi lejohet, dhe është i saktë**, si në rastin kur muri i xhamisë është i plotë, ashtu edhe në rastin kur muri është i shkurtër.

Madje edhe në rastin kur nuk ka mur fare, sipas mendimit më të saktë, siç thotë shejh Bin Bazi, Ibn Uttejmini dhe shumica e dijetarëve.

Sepse argumentet ndalojnë nga falja në varre, dhe në drejtim të varreve.

Xhamia në këtë rast nuk është në varreza, por varret janë vendosur aty pas ndërtimit të saj.

Si dhe varret janë anash dhe mbrapa, dhe nuk janë para (nga ana e kibles).

Nëse do ishin para, nga ana e kibles, dhe nuk ka mure, atëherë nuk lejohet namazi.

Ama nëse është muri i xhamisë, dhe është i plotë, kjo është e mjaftueshme që të konsiderohet namazi i saktë sipas mendimit të shumicës së dijetarëve.

▪ Nëse xhamia ka oborr dhe mure rrethuese (havli), dhe ka derë për hyrje-dalje, ky oborr merr gjykimin e xhamisë, siç thotë Shejh Albani.

Nëse brenda këtij oborri (brenda murit rrethues -havisë-) ka varre, këto varre konsiderohen që janë brenda xhamisë, dhe kjo është shumë e rrezikshme, siç e kam përmendur në mësimet përpara.

Varret në këtë rast:

- Ose duhet të nxirren, të zhvarrosen, dhe të nxirren eshtrat.
- Ose të ndahen nga xhamia me mur i cili i nxjerr (i ndan) ato nga territori i xhamisë.

Shejh Albani thotë: më e mira është të ndahen me mure, dhe jo të zhvarrosen dhe të nxirren eshtrat.

▪ Nëse ka xhami tjetër aty afër, pa varre jashtë:

- Nëse nuk ka vështirësi për të shkuar aty, atëherë nuk ka dyshim se më parësore është me u fal te kjo xhami pa varre.
- Nëse varret janë nga ana e kibles edhe pse muri i xhamisë është i plotë, kërkesa në formë të pëlqyer që të shkoje të falet në një xhami tjetër pa varre (kur ka mundësi) është më e madhe se në rastin kur varret janë në anët e tjera të xhamisë.
- Ama, nëse përton me shku te xhamia pa varre përreth saj, dhe falet në këtë xhami me varre përreth saj, namazi është i saktë (sipas shpjegimit të lartpërmendur).

All-llahu e di më së miri.

● SQARIM NË LIDHJE ME VARRIN E PROFETIT (sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem) NË XHAMINË E TIJ.

Disa të cilët e lejojnë faljen në xhami ku ka varr, argumentohen me varrin e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem në xhaminë e tij.

Ky argumentim pa dyshim që është i kotë, nuk është i vërtetë, dhe si i tillë nuk qëndron.

Sepse Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem nuk është varrosur në xhami.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem është varrosur në shtëpinë e tij.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem aty ku ka vdekur, aty është varrosur.

Thotë Profeti sal-lall-llahu alejhi ue:

ما قبض الله نبيا إلا في الموضع الذي يحب أن يدفن فيه
[الترمذي و غيره ، صححه الالباني]

Kuptimi:

“All-llahu çdo Profeti ia ka marrë shpirtin në vendin në të cilin dëshiron të varroset.”

[Transmeton Termidhiu etj. Albani thotë është hadith i saktë]

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka vdekur në shtëpinë e tij, në dhomën e Aishes radijall-llahu anha. Që do të thotë se aty ka dëshiruar të varroset.

Prej urtësisë së varrosjes së Profetit në shtëpinë e tij është se ai ka pasur frikë se nëse do varroset jashtë, me njerëzit, ata do e bënin varrin e tij vendfalje.

Thotë Aishe radijall-llahu anha:

"Sikur mos të ishte frika se varri i tij do bëhej vendfalje, do u varroste jashtë (me njerëzit)."

[Transmeton BUHARI]

Shtëpia e Profetit (dhoma e Aishes radijall-llahu anha) ka qenë shumë afër xhamisë.

Pas vdekjes së Sahabëve radijall-llahu anhum, pas viteve 80 Hixhri, Halifi i asaj kohe El Uelid Bin Abdul Melik urdhëroi zgjerimin e xhamisë së Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, dhe urdhëroi që zgjerimi të jetë edhe nga ana lindore.

Zgjerimi në anën lindore do të thotë që të futet varri i Profetit brenda xhamisë.

Dijetarët e asaj kohe e këshilluan, duke i thënë se kjo nuk bën, por ai refuzoi.

Dhe kështu u fut varri i Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem në xhami.

Sahabët pothuajse të gjithë kishin vdekur, sidomos në Medine.

Që do të thotë se nese do u bënte kjo gjë duke qenë disa prej tyre gjallë, dhe ata do heshtnin, atëherë mund të merret për argument.

Ne shohim se në kohën e tyre, në kohën e Umerit dhe Uthmanit, ata e kanë zgjeruar xhaminë, ama varrit të Profetit nuk i janë afruar.

Madje është transmetuar se Umeri thonte:

“Vetëm nga ajo anë jo.”

(dmth: mos të zgjerohet xhamia nga ana e varrit të Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem).

Sahabët e kanë ditur që kjo nuk bën.

Po ashtu edhe tabiinët pas tyre.

Shumë prej tyre e kundërshtuan vendimin e Halifes, dhe e këshilluan mos t’a bëje.

Që do të thotë se nuk ka argument, as fjalë Sahabësh, që e lejon varrosjen në xhami, dhe futjen e varrit në xhami.

Ky qe një veprim i gabuar i Halifes së asaj kohe (All-llahu na falt ne dhe atë).

Duke qenë kjo, një vepër e gabuar e një personi, në kundërshtim të argumentit, si mund të bazohesh në këtë, dhe t’a marrësh për argument atë që është në kundërshtim me argumentin?!

Megjithatë, edhe pse varri i Profetit u fut në xhami, ai është anash nga muri lindor i xhamisë. Njerëzit falen nga ana perëndimore e varrit, ndërsa nga ana lindore është muri i xhamisë, dhe nuk falet njeri.

Varri është i ndarë me tre mure në forme pesë-këndore siç thotë Shejh Suhejmi (myftiu i Medines), plus murit kryesor.

Kështu që, edhe ata që falen nga ana e pasme, që i bie t’a kenë varrin nga kibla, ndërmjet tyre dhe varrit janë më shumë se tre mure ndarës.

Pra, ata që pretendojnë se lejohet falja në xhami ku ka varre me këtë argument, pretendimi i tyre është i kotë, i pa bazë.

Është në kundërshtim me argumentat e sakta dhe të qarta, dhe në kundërshtim me realitetin e varrit të Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem në xhami.

All-llahu e di më mirë.

Ai është më i Dijshmi.

Kudo që ia kam qëlluar është prej All-llahut, ndërsa aty ku kam gabuar është prej vetes time dhe shejtanit.

و. صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه وسلم.